

## MARRËVESHJA E LIÇENSIMIT TË BLACKBERRY SOLUTION

### JU LUTEM LEXONI KËTË DOKUMENT ME KUJDES PËRPARA INSTALIMIT APO PËRDORIMIT TË PROGRAMIT.

Kjo Marrëveshje e Liçensimit së BlackBerry Solution ("Marrëveshja"), versionet e mëparshme të së cilës janë të referuara si Marrëveshja e Liçensës të Programit BlackBerry, është një marrëveshje e ligjshme midis Jush, individualisht nëse jeni duke rënë dakord me të nën cilësinë tuaj personale, ose jeni të autorizuar ta merrni Programin në emër të shoqërisë ose të ndonjë enti tjetër, midis entit për llogari të së cilit ju veproni (në secilin rast, "Ju"), dhe Research In Motion UK Limited, me Nr. të Shoqërisë 4022422 ("RIM") zyra qendrore e së cilës është në, Centrum House, 36 Station Road, Egham, Surrey, UK TW20 9LF ("Palët" së bashku dhe individualisht një "Palë"). Për sa i përket liçensës dhe shpërndarjes së Programit (siç përcaktohet më poshtë) RIM është qoftë në mënyrë direkte ose indirekte i liçensuar nga: (a) Research in Motion Limited ("RIM Canada") ose ndonjë ose më shumë prej shoqërive të kontrolluara dhe filialeve të saj (shoqëritë e kontrolluara dhe filialet sëbashku me RIM Canada referohen në këtë marrëveshje si "Shoqëritë e Grupit RIM"); ose (b) një liçensues i palës së tretë të ndonjë prej Kompanive të Grupit RIM duke përfshirë RIM.

DUKE TREGUAR PRANIMIN TUAJ QOFTË DUKE KLIKUAR NË BUTONIN PËRKATËS ME POSHTË, OSE DUKE SHKARKUAR, INSTALUAR, AKTIVIZUAR OSE DUKE PËRDORUR PROGRAM-IN, JU JENI DUKE RËNË DAKORT PËR TË RESPEKTUAR KUSHTET E KESAJ MARRËVESHJEJE. NËSE KENI NDONJË PYETJE APO SHQETËSIM NË LIDHJE ME KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE, JU LUTEM KONTAKTONI ME RIM NË LEGALINFO@RIM.COM.

DUKE TREGUAR PRANIMIN TUAJ ME KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE NË MËNYRËN E SIPËR PËRMËNDUR, JU JENI GJITHASHTU DUKE RËNË DAKORT SE KJO MARRËVESHJEJE ZËVËNDËSON MARRËVESHJEN EKZISTUESE TË LIÇENSËS KONSUMATORIT TË PROGRAMIT BLACKBERRY DHE MARRËVESHJEN E LIÇENSËS TË PROGRAMIT TË SERVERIT BLACKBERRY ENTERPRISE DHE ÇDO MARRËVESHJEJE TJETËR TË MËPARSHME EKZISTUESE TË LIÇENSËS TË PROGRAMIT BLACKBERRY PËR AQ SA MARRËVESHJEJE TË TILLA JANË TË ZBATUESHME NDRYSHE QË NGA DATA E PRANIMIT TUAJ TË KËSAJ MARRËVESHJEJE NË ÇDO PROGRAM QË ËSHTË PJESË E BLACKBERRY SOLUTION SUAJ (PËR INFORMACION TË METËJSHEM, SHIH ME POSHTË PIKËN ME TITULL "BASHKIMI I MARRËVESHJEVE" (PIKA 27)).

#### Rikthim.

NËSE, PËRPARA SE TË SHKARKONI, INSTALONI, AKTIVIZONI OSE TË PËRDORNI PROGRAMIN, JU VENDOSNI SE NUK KENI DËSHIRË TË PRANONI KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE, JU NUK KENI TË DREJTË TË PËRDORNI KETË PROGRAM DHE JU DUHET QË: (A) TA KTHENI MENJËHËRË PROGRAMIN TEK RIM, TA FSHINI, OSE TA ÇAKTIVIZONI ATË; (B) NËSE KENI BLËRË NJË PRODUKT TË RIM-IT NË TË CILIN PROGRAMI ËSHTË INSTALUAR MË PARË NGA OSE NË EMËR TË RIM, KTHEJENI MENJËHËRË PRODUKTIN E RIM DHE PROGRAMIN DHE ARTIKUJT SHOQËRUES (DUKE PËRFSHIRË DOKUMENTACIONIN DHE PAKETIMIN) TEK RIM OSE TEK DISTRIBUTORI I AUTORIZUAR PREJ TË CILIT JU MORËT PRODUKTIN E RIM-IT DHE PROGRAMIN DHE ARTIKUJT SHOQËRUES; OSE (C) NË SE JU KENI BLËRË NJË PRODUKT HANDHELD NGA NJË PALË E TRETË NË TË CILIN PROGRAMI ËSHTË INSTALUAR MË PARË NGA RIM OSE NË EMËR TË RIM-IT, MERRNI MASAT

MENJËHËRË PËR ÇAKTIVIZIMIN E PROGRAMIT ME RIM OSE ME DISTRIBUTORIN E AUTORIZUAR TË RIM, PREJ TË CILIT JU PËRFITUAT PRODUKTIN HANDHELD TË PALËS SË TRETË DHE PROGRAMIN DHE ARTIKUJT E TJERË SHOQËRUES. Nëse, në rrethanat e përcaktuara më lart, Ju keni paguar për Programin, dhe/ose për produktin RIM që Ju morët me këtë Program dhe nuk jeni në gjëndje ta përdorni dobishmërisht pa atë Program, (siç zbatohet), dhe Ju i jepni RIM-it ose distributorit të autorizuar prej të cilit Ju morët Programin për Produktet e RIM-it me vërtetimin e blerjes tuaj brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data që Ju morët programin, RIM ose distributori i autorizuar do t'ju kthejë Juve paratë (nëse ka) që keni paguar për këto artikuj. Për tu rimbursuar për Programin në Produkte të Palëve të Treta (vini re se sidoqoftë Programi i disa Produkteve Handheld të Palës së Tretë jepet pa pagesë dhe si rrjedhojë mund të mos keni asgjë për rimbursim) ju lutem kontaktoni distributorin Tuaj të autorizuar të Programit për atë Produkt Handheld të Palës së Tretë. Nëse, në rrethanat e përcaktuara më lart, Ju nuk jeni në gjëndje të merrni paratë për Programin nga një distributor i autorizuar ju lutem kontaktoni RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).

KJO MARRËVESHJE NUK NDIKON NË TË DREJTAT TUAJA LIGJORE TË DETYRUESHME TË ZBATUESHME NË JURIDIKSIONIN TUAJ, PËR AQ SA JU MUND TË KENI TË DREJTA TË TILLA LIGJORE TË DETYRUESHME.

1. Përkufizime. Përveç kur përmbajtja kërkon ndryshe, kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimet e përcaktuara me poshtë (dhe ku përmbajtja lejon njëjësin duhet përfshihet shumësi dhe anasjelltas).

"Shërbimi Airtime" do të thotë shërbim i rrjetit pa kabëll të një zonë të gjërë, shërbimet e tjera të rrjetit (duke përfshirë rrjetin lokal pa kabëll, shërbimet satelitore dhe të Internetit) dhe çdo shërbim tjetër të ofruar nga Furnizuesi i Shërbimit Airtime për përdorim në lidhje me Tuajin BlackBerry Solution.

"Furnizues i Shërbimit Airtime" nënkupton një ent që ofron shërbimet e rrjetit pa kabëll të një zone të gjërë, dhe mund të ofrojë Shërbime të tjera Airtime që përballojnë ose përmirsojnë Tuajin BlackBerry Solution.

"Përdorues të Autorizuar" do të thotë cilido nga të meposhtmit të cileve Ju i lejoni të përdorin Programin si pjesë e Tuajit BlackBerry Solution: (a) cilido prej punonjësve Tuaj, konsulent apo kontraktues të pavarur; (b) ndonjë mik apo anëtar i familjes, ose çdo person që jeton në banesën Tuaj; dhe (c) çdo person tjetër të cilin RIM e autorizon me shkrim. Kjo Marrëveshje nuk përcjellë të drejtën automatike që Programi Juaj i Serverit BlackBerry të pritët nga një palë e tretë, nëse Ju dëshironi të veproni kështu, ju lutem kontaktoni RIM në: [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).

"Produkt Handheld BlackBerry", i njohur gjithashtu si "BlackBerry Devices", do të thotë një pajisje e mbajtshme në dore pa kabell e prodhuar nga ose për llogari të RIM, duke përfshirë çdo smartphone të tillë, lexues karte smart, ose BlackBerry Presenter dhe çdo pajisje tjetër të identifikuar qartë nga RIM në [http://www.blackberry.com/legal/blackberrydevices\\_for\\_bbsla](http://www.blackberry.com/legal/blackberrydevices_for_bbsla) si një Produkt BlackBerry Handheld.

"Program Handheld BlackBerry" do të thotë Program që ka në pronësi RIM-i (i përfshire nga pronësia e RIM: program, firmware, ndërfaqet, përmbajtje dhe të dhëna të tjera, nëse konsiderohen ose jo teknikisht kode të programit; dhe Përbërësit e Palës së Tretë), ose ndonjë pjesë të saj, e projektuar për përdorim në Produktit Handheld që është: (a) i ngarkuar në Produktin Handheld në mënyrë origjinale ashtu siç është transportuar nga RIM; ose (b) e

transmetuar, e shpërndarë ose që ju është vënë në dispozicion në një mënyrë tjetër nga apo në emër të RIM here pas here për t'u përdorur në Produktin Tuaj Handheld. Modele të Programit BlackBerry Handheld përfshijnë sistemin kompjuterik operativ nga pronësia e RIM dhe aplikime të para-instaluar në një Produkt Handheld BlackBerry nga pronësia e RIM, ose të përfshira në "Paketën e Aplikimit të BlackBerry" produkt të transmetuar, të shpërndarë ose që Ju është vënë në dispozicion në një mënyrë tjetër nga apo në emër të RIM për t'u përdorur here pas here në Produktet Handheld të Palës së Tretë.

"Program i Kompjuterit Personal BlackBerry" do të thotë Program që ka në pronësi RIM-i (i përbërë nga pronësia e programit të RIM, ndërfaqet, përmbajtja dhe të dhëna të tjera, nëse konsiderohen ose jo teknikisht kode të programit; dhe Përbërësit e Palës së Tretë), ose ndonjë pjesë të saj, e projektuar për përdorim si pjesë e Tuajit BlackBerry Solution vetëm për një konsumator të vetëm për ta përdorur dhe hyrë në një kompjuter personal në çdo kohë. Një model i Programit të Kompjuterit Personal BlackBerry është "Programi BlackBerry i Desktop-it", i cili mund të përdoret për sigurimin dhe për ruajtjen e sinkronizimin ndërmjet Produktit Tuaj Handheld dhe kompjuterit Tuaj personal dhe siguron funksionimin e organizimit të desktopit.

"Shërbimet Prosumer BlackBerry" janë shërbime të projektuara dhe të ofruara nga RIM për të pajisur klientët e RIM me disa funksionalitete të ofruara nga Programi BlackBerry që ka në pronësi RIM-i pa qënë e nevojshme blerja e këtij programi server nga konsumatorët e RIM. Shërbimet Prosumer BlackBerry përfshijnë "Shërbim Interneti BlackBerry" të RIM-it. Shërbimi i Internetit BlackBerry mundëson të abonuarit që: (a) të integrojnë disa ISP ose llogari të tjera e-maili të palëve të treta për dërgesa të bazuara në shtytje në Produktin Tuaj Handheld; (b) të krijojnë një adresë e-mail të bazuar në aparat për Produktin Tuaj Handheld; dhe (c) akses në disa përmbajtje dhe shërbime në Internet. Funksionaliteti i e-mailit i Shërbimit të Internetit BlackBerry është gjithashtu i njohur edhe si "MyEmail", "BlackBerry Internet Mail" dhe/ose një emër produkti specifik të Furnizuesit të Shërbimit Tuaj Airtime. Të gjitha ose disa nga Shërbimet Prosumer BlackBerry mund të mos mbështeten nga Furnizuesi i Shërbimit Tuaj Airtime. Ju lutem kontrolloni me Furnizuesin e Shërbimit Tuaj Airtime për disponibilitet.

"Programi i Serverit BlackBerry" do të thotë Program server që ka në pronësi RIM-i (i përbërë nga pronësia e RIM: programi, ndërfaqet, përbërja dhe të dhëna të tjera, që mund ose jo teknikisht të konsiderohen kode programi, duke përfshirë pa kufizim identifikuesin e protokollit të kursit të serverit (SRP ID), celësin e vërtetimit të SRP dhe çdo identifikues tjetër që RIM ofron për përdorim me një kopje të vecantë të programit të serverit; dhe Përbërësit e Palës së Tretë) ose ndonjë pjesë të saj, një kopje e vetme e së ciles është projektuar që të instalohet në një kompjuter dhe të ketë akses nga një sërë Produktesh Handheld në të njëjtën kohë. Modele të Programit të Serverit BlackBerry përfshijnë produktin "Serverin BlackBerry Enterprise", i cili është projektuar për t'u integruar dhe për të siguruar një lidhje ndërmjet serverave që aplikojnë së bashku (siç janë serverat e e-mail-it) dhe Produktet Handheld të pajisur për të operuar me programin "BlackBerry Enterprise Server" dhe programin "BlackBerry Mobile Voice", i cili është projektuar që të vendos në dispozicion të Produkteve Handheld karakteristikat e telefonit të zyrës.

"BlackBerry Solution" do të thotë Programi, dhe të paktën një nga artikujt e mëposhtëm shtesë për përdorim në lidhje me Programin: Produkti RIM, Programi i Serverit BlackBerry, Programi BlackBerry Handheld, Program i kompjuterik personal BlackBerry dhe/ose të Shërbimeve; së bashku me Documentacionin e aplikueshëm.

"Dokumentacion" do të thotë guida e aplikueshme e instalimit ose dokumentacioni standart i Përdoruesit Fundor i përgatitur dhe i pajisur nga RIM për llojin dhe versionin e vecantë të Programit, Produktit ose Shërbimit të RIM-it, duke përfshirë dhe udhezimet e sigurisë. Dokumentacioni është gjithashtu i disponueshem në <http://docs.blackberry.com> ose duke kontaktuar RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com). Për siguri, Dokumentacioni nuk përfshin ndonjë guide të instalimit ose dokumentacion të Përdoruesit Fundor që është i përgatitur nga ndonjë person tjetër që nuk është RIM ose ndonjë modifikim të bërë në dokumentacion e bërë nga ndonjë person tjetër që nuk është RIM.

"Produkt Handheld" do të thotë: (a) një Produkt BlackBerry Handheld; ose (b) një Produkt Handheld i Palës së tretë.

"Periferikët e RIM" do të thotë: pajisje ose artikuj të tjerë duke përfshirë, pa kufizim, karta memorie microSD apo memorie të tjera të zgjerueshme dhe Kufje të projektuara për të punuar në lidhje me një Produkt RIM që mbajnë markën RIM.

"Produkt RIM" do të thotë cilido prej Produkteve BlackBerry Handheld dhe çdo Periferi RIM ekskluzivisht të ndonjë Programi.

"Program" do të thotë cilido prej Programeve BlackBerry Handheld, Programeve të kompjuterit personal BlackBerry apo Programi i Serverit BlackBerry të cilët ju janë dhënë juve në bazë të kësaj Marrëveshje, në çfarëdo forme, mjete apo mënyrën e siguruar apo të instaluar ose të përdorur më pas. Nëse Programi i Serverit BlackBerry ka aftësinë që të mundësojë (p.sh. të aktivizojë) Programin BlackBerry Handheld, atëherë, termi "Program" përfshin ndonjë ose të gjitha Programet BlackBerry Handheld (duke përfshirë çdo dhe të gjitha azhurnimet ose përmirësimet atje për të cilat kushtet dhe afatet e tjera nuk janë të parashikuara) që është aktivizuar duke përdorur Programin. Termi "Program" nuk do të përfshijë ndonjë Program të Palës së Tretë ose Përbërje të Palës së Tretë, edhe nëse ky Program i Palës së Tretë ose Përbërje e Palës së Tretë është shpërndarë nga RIM, ose Programi i Palës së Tretë ose Përbërje e Palës së Tretë të shoqëruar, është i pajisur, apo operon në lidhje me, Programin dhe/ose ndonjë pjesë tjetër të Tuajit BlackBerry Solution apo të Produktit Handheld të Palës së Tretë.

"Shërbim(e)" do të thotë çdo shërbim RIM që Ju ofrohet nga ose në emër të RIM si pjesë e Tuajit BlackBerry Solution (duke përfshirë pa kufizim, çdo shërbim të RIM, si Shërbimi BlackBerry Prosumer, për të cilën Ju abonoheni, dhe çdo shërbim të ri të RIM ose modifikim të ndonjë shërbimi ekzistues RIM që siguron RIM, ose që përndryshe Jua ben të disponueshëm herë pas here).

"Përbërësit e Palës së Tretë" do të thotë programet dhe ndërfaqet, e licensuara nga RIM nga një palë e tretë për bashkëpunim në një produkt programi RIM, ose për përfshirjen në firmware në rastin e produkteve hardware RIM, dhe të shpërndarë si një pjesë integrale e atij produkti të RIM nën markën e RIM, por nuk do të përfshijë Programet e Palës së Tretë.

"Përmbajtja e Palës së Tretë" do të thotë përmbajtja e Palës së Tretë, duke përfshirë, pa kufizim, dosjet e palës së tretë, bazë të dhënash dhe faqet e Internetit.

"Produkt Handheld i Palës së Tretë" do të thotë çdo smartphone pa kabëll handheld, ndryshe nga një Produkt BlackBerry Handheld, në të cilin është projektuar nga RIM një Program BlackBerry Handheld ose pjesë e tij për të vepruar, dhe në lidhje me të cilën RIM ka hyrë në

një marrëveshje me Furnizuesin Tuaj të Shërbimit Airtime duke autorizuar atë pajisje pa kabell të palës së tretë të ketë akses në infrastrukturën e RIM.

"Artikujt e Palës së Tretë" do të thotë Hardware të Palës së Tretë, Program i Palës së Tretë, Përbajtja e Palës së Tretë dhe Produktët e Palës së Tretë.

"Hardwaret e Palës së Tretë" do të thotë Produktet Handheld, kompjuter, pajisje, periferikësh dhe çdo produkt tjetër hardware që nuk është një produkt RIM.

"Produktet e Palës së Tretë" do të thotë Hardware i Palës së Tretë dhe Program i Palës së Tretë dhe të gjitha produktet e tjera tregtare që nuk janë Produkte të RIM.

"Shërbimet e Palës së Tretë" do të thotë shërbimet e siguruar nga një palë e tretë, duke përfshirë Shërbimin Airtime dhe çdo faqe interneti që nuk operohet nga RIM-i.

"Programet e Palës së Tretë" do të thotë aplikimet e pavarura të programit në pronësi të palës së tretë që janë ofruar ose përndryshe që janë vërë në dispozicion nga, me ose ndërmjet Produkteve ose Programeve RIM. Modele të Programeve të Palës së Tretë janë DataViz's "Dokumentet To Go", të gjëndura në disa Produkte BlackBerry Handheld, dhe Sonic Solution "Roxio Media Manager", nëse ajo është dhënë në lidhje me Programet Desktop BlackBerry.

"BlackBerry Solution i Juaji" do të thotë Programi, dhe të paktën një prej pajisjeve shtesë të mëposhtme të cilat Ju i merrni, i instaloni, i aktivizoni, ose përndryshe i autorizoni dhe pranoni përgjegjësinë për përdorimin, në lidhje me Programin, siç zbatohet në rrethanat tuaja: Produkti RIM, Programi i Serverit BlackBerry, Programi BlackBerry Handheld, Programi i kompjuterit personal BlackBerry dhe/ose Shërbimi(et); së bashku me Dokumentacionin përkatës.

2. Liçensa e Programit dhe Dokumentacionit. Programi sipas kësaj Marrëveshjeje është i liçensuar dhe nuk shitet. Liçensa Juaj për të përdorur Programin është e kushtëzuar me pagesën e tarifave të liçensës, nëse ka. Duke iu përbajtur kushteve dhe afateve të saj, kjo marrëveshje ju jep Juve një liçensë personale, të revokueshme, jo-ekskluzive, të pa transferueshme që ju lejon Juve dhe Përdoruesve Tuaj të Autorizuar, së bashku:

- (a) nëse Programi është Program i Serverit BlackBerry:
  - (i) të instaloni dhe të përdorni numrat e kopjeve (duke përfshirë dhe kopjet virtuale) të Programit duke iu korresponduar tarifave të paguara RIM-it ose distributorit të autorizuar të RIM për Programin (dhe nëse asnjë pagesë nuk është paguar për Programin RIM apo distributorit të autorizuar të RIM, atëherë instaloni dhe përdorni numrat e kopjeve vetëm me autorizimin me shkrim të RIM ose të distributorit të autorizuar të RIM); dhe
  - (ii) për të mundësuar numrin e Produkteve Handheld që i korrespondojnë tarifës së paguar RIM-it ose distributorit të autorizuar të RIM të kenë akses në Program, (dhe nëse asnjë pagesë nuk është paguar RIM apo distributorit të autorizuar të RIM për të mundësuar aksesin e Produkteve Handheld të Programit, atëherë mundësoni numrin e kopjeve të Produktëve Handheld vetëm me autorizimin me shkrim të RIM ose të distributorit të autorizuar të RIM) (për shembull, nëse Ju po përdorni Programin e "Serverit BlackBerry Enterprise", Ju duhet të siguroni liçensat e aksesit ("CALs") të klientit për numrin e Produkteve Handheld

që përdoren në lidhje me atë tip Programi të Serverit BlackBerry ose për ndryshe të merrni autorizim nga RIM duke përcaktuar numrin e Përdoruesve të Autorizuar që lejohen të hapin atë Program); dhe

- (b) nëse Programi është Programi BlackBerry Handheld apo Programi Kompjuterit personal BlackBerry dhe:
  - (i) nëse Programi është instaluar më parë në hardware, më pas, të përdorni kopjen e vetme të atij Programi të instaluar në hardware; ose
  - (ii) nëse Programi nuk është instaluar më parë në hardware, atëherë, për të instaluar dhe përdorur Programin, mbi numrin e njërive të hardwarave të aplikueshëm duke i korresponduar tarifave që janë paguar RIM-it apo distributorit të autorizuar të RIM (dhe nëse asnjë pagesë nuk i paguhet RIM-it apo distributorit të autorizuar të RIM për Programin, atëherë instaloni dhe përdorni numrin e kopjeve vetëm të autorizuara me shkrim nga RIM ose nga distributori i autorizuar i RIM).

Nëse Jeni duke marrë Programin (dhe ndonjë CALs në lidhje me të) në baza abonimi ose si pjesë e një përdorimi falas, atëherë të drejtat e licencës të përcaktuara më sipër zbatohen vetëm për periudhën e kohës për të cilën ju keni paguar tarifën e abonimit të nevojshëm ose për periudhën e autorizuar nga RIM apo shpërndarësi i tij i autorizuar, sipas rastit).

Në të gjitha rastet, licensa(t) e dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje, ju lejon Juve dhe Përdoruesve Tuaj të Autorizuar të përdorni ose të lejoni përdorimin e Programeve ose për të patur akses në Shërbimet vetëm për qëllimin Tuaj të brendshëm ose personal dhe vetëm si pjesë e Tuajit BlackBerry Solution. Nëse një Përdorues i Autorizuar gjithashtu dëshiron të përdorë Programin Handheld BlackBerry, si pjesë e një tjetër BlackBerry Solution (p.sh. një BlackBerry Solution e përbërë në pjesë prej produkteve që ka në pronësi RIM, programe apo shërbime të cilat Ju, apo dikush që vepron në emrin Tuaj, nuk i keni marrë, instaluar ose parashikuar, dhe që Ju jeni të përgatitur për ti lejuar, por nuk pranoni përgjegjësi, për një përdorim të tillë; "të tjera të BlackBerry Solution"), atëherë ky përdorim nuk përfshihet në këtë marrëveshje të licencës dhe Ju duhet ti kërkonte Përdoruesit të Autorizuar të hyjë vecmas në një marrëveshje të licencës me RIM i cili i jep të drejtën atij ose asaj të përdorë Programin Handheld BlackBerry si pjesë e një Zgjidhje Tjetër BlackBerry (P.sh. nëse Ju jeni një korporatë dhe punëtori Juaj dëshiron të përdor Programin BlackBerry Handheld në lidhje me shërbimet BlackBerry Prosumer personale të tij ose të saj, dhe Ju jeni të përgatitur t'ia lejonit, por jo të mbani përgjegjësi për këtë përdorim, i punësuarit Juaj duhet, vec faktit i të qenit një Përdorues i Autorizuar sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të lidh një Marrëveshje Licensë Programi BlackBerry me RIM, në cilesinë e tij ose të saj personal, duke marrë të drejtën për të përdorur Programin me këtë Zgjidhje Tjetër BlackBerry. Në shumicën e rasteve Marrëveshja e Licencës së Programit BlackBerry do t'i jepet individit nëse ai ose ajo pajisë programin BlackBerry Handheld për përdorim me Shërbimet BlackBerry Prosumer, dhe është ndryshe e mundshme nga RIM në [www.blackberry.com/legal](http://www.blackberry.com/legal). Në mënyrë të ngjashme nëse Ju keni një BES Hosted akses të Marrëveshjes në vend, konsumatorët Tuaj duhet të hyjnë në një Marrëveshje në mënyrë që të përdorin Programin Enterprise Server BlackBerry si pjesë e Zgjidhjes së tyre BlackBerry).

Kjo Marrëveshje dhe licensat e dhëna ketu nuk përfshijnë ndonjë të drejtë mbi: (a) përmirësime apo azhornime të ardhme të Programit apo të Programit të Palës së Tretë; (b) në rastin e Programit BlackBerry Handheld në një Produkt Handheld, mundësia për të patur akses mbi aplikimet, përvec atyre të përfshira në Program; ose (c) të përfitonit ndonjë Shërbim të ri apo të modifikuar. Pavarësisht nga sa mësipër, Programi mund të përfshijë funksionalitetin për të kontrolluar automatikisht për përmirësime apo azhornime në Program. Përvec kur Ju, apo një palë

e tretë me të cilën Ju keni bërë një marrëveshje për të siguruar Tuajin BlackBerry Solution ose pjesë të saj, konfiguroni Tuajin BlackBerry Solution për të parandaluar transmetimin apo përdorimin e përmirësimit apo azhornimit në Program, Programe apo Shërbimet e Palës së Tretë, Ju në këtë mënyrë bini dakord që RIM të mund të vejë (por nuk është i detyruar) në dispozicion këtë përmirësim apo azhornim për Ju herë pas here. Nëse RIM, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet një distributori (duke përfshirë Furnizuesin e Shërbimit Airtime), Ju mundëson Juve një përmirësim apo azhornim në Programet apo në Shërbimet, keto përmirësime apo azhornime do të jenë pjesë e kushteve të kësaj Marrëveshjeje përveç nëse Programet apo Shërbim(et) Ju janë mundësuar shprehimisht në kushte të tjera, ose plotësuese, në këtë rast, në qoftë së Ju pranoni afatet dhe kushtet e lidhur ose përdorni përmirësimet dhe azhornimet, këto kushte të tjera, ose kushte plotësuese (që mund të përfshijnë pagesën e tarifave plotësuese), do të zbatohen.

Ju nuk mund të printoni, shpërndani apo të modifikoni Programin, në tërësi apo pjesërisht. Përveç për aq sa RIM është i ndaluar me ligj të ndaloje keto aktivitete, Ju nuk mund të kopjoni, riprodhoni ose në mënyra të tjera të dublikoni Programin, në tërësi apo pjesërisht, përveç si është autorizuar në këtë Marrëveshjeje ose në marrëveshje të shkruar vetë ndërmjet Jush dhe RIM. Për qëllimet e kësaj dispozite "kopjimi" apo "riprodhimi" nuk do të përfshijë kopjimin e deklarimeve dhe udhëzimeve të Programit që ndodhin gjatë ekzekutimit normal të programit kur përdoret në përputhje me apo për qëllime të përshkruara në dokumentacion, ose në procesin e kontrolleve të rregullta të pa modifikuar të Programit ose të kompjuterit apo sistemit tuaj në të cilin është instaluar Programi, në përputhje me praktikën standarte të biznesit të industrisë. Ju nuk mund të kopjoni ndonjë Dokumentacion apo pjesë të tij përveç kur ju autorizohet specifikisht me shkrim nga RIM të veproni kështu. Ju mund të shkarkoni një kopje të vetme të Dokumentacionit nga <http://docs.blackberry.com> vetëm për përdorimin Tuaj sipas këtyre afateve dhe kushteve dhe në lidhje me përdorimin e programit.

3. Përdorimi i Tuajit BlackBerry Solution. Ju jeni përgjegjës për të gjitha veprimet në lidhje me Tuajin BlackBerry Solution të ndërmarra nga Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar dhe Ju do të siguronit se:

- (a) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar do të përdorni Tuajin BlackBerry Solution dhe ndonjë pjesë të saj vetëm, në përputhje me këtë Marrëveshjeje, të gjitha ligjet e aplikueshme dhe rregulloret, dhe dokumentacionin përkatës për Tuajin BlackBerry Solution dhe ndonjë pjesë të saj;
- (b) Ju keni të drejtën dhe autoritetin të lidhni këtë Marrëveshjeje, qoftë në emrin Tuaj apo në emër të një kompanie apo enti tjetër dhe Ju të keni mbushur moshën madhore;
- (c) Çdo informacion që i sigurohet RIM në vijim të kësaj Marrëveshjeje është i vërtetë, i saktë, aktual dhe i plotë;
- (d) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të merrni përsipër me vetëdije, pasi të keni bërë këto kërkitime si person i arsyeshëm në cilësinë Tuaj apo të Përdoruesit Tuaj të Autorizuar, të përdorni ose të lejoni të tjerët të përdorin Tuajin BlackBerry Solution apo pjesë të tjera vetëm ose në kombinim me programe të tjera ose të dhëna, në një mënyrë që sipas gjykimit të RIM, duke vepruar me arsye, interferojnë me, prishin apo ndikojnë negativisht në Program, sistem, rrjet apo të dhëna që përdoren nga ndonjë person duke përfshirë RIM apo një Furnizues të Shërbimit Airtime ose që përndryshe ka një efekt të dëmshëm kundrejt RIM,

Grupit të kompanive të RIM, një Furnizuesi të Shërbimit Airtime apo ndonjë prej klientëve të tyre ose produkteve apo shërbimeve, dhe Ju menjëherë do të ndërpriti çdo veprim të tillë sapo RIM t'ju ketë njoftuar për një gjë të tillë;

- (e) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të transmetoni mesazhe ngacmuese, shpifese, të paligjshme dhe mashtruese, apo informacion duke përdorur Tuajin BlackBerry Solution apo ndonjë pjesë të tij
- (f) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të përdorni Tuajin BlackBerry Solution apo ndonjë pjesë të saj, për të kryer apo për të tentuar për të kryer një krim ose për të lehtësuar dikë tjetër në kryerjen e një krimi ose akte të tjera ilegale apo të gabuara, duke përfshirë çdo cënim ose shkelje të jetës private, dhunim ose keqpërdorim të çdo të drejtë të pronës intelektuale dhe të drejta të tjera pronësie të ndonjë pale të tretë (duke përfshirë pa kufizim, kopjimin dhe ndarjen e Përmbajtjes së Palës së Tretë, për të cilën Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk keni të drejta ti kopjoni ose ti ndani, ose duke shmangur në mënyrë të paligjshme mbrojtjen e ndonjë të drejtë dixhitale të menaxhimit);
- (g) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do ta shisni, jepni apo merrni me qera, ta nën-liçensoni, apo ta transferoni ose të tentoni ta shisni, jepni apo merrni me qera, ta nën-liçensoni, apo ta transferoni Programin apo ndonjë pjesë të tij, apo titullin Tuaj për të përdorur shërbimet apo ndonjë pjesë të tyre, (duke përfshirë operimin e një zyre shërbimi ose shërbim ekuivalent që përdor Programin) ndonjë personi tjetër, pa lejen e deklaruar me shkrim me përpara nga RIM;
- (h) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të transferoni, apo të tentoni të transferoni, ndonjë Program apo ndonjë pjesë të saj të instaluar më parë nga apo në emër të RIM në një Produkt RIM për t'u përdorur në çdo pajisje tjetër pa lejen e deklaruar me shkrim me përpara nga RIM.
- (i) Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar do të bashkëpunoni me RIM dhe të siguronin informacionin e kërkuar nga RIM për të ndihmuar RIM në hetimin dhe përcaktimin nëse ka patur një shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe ti mundësoni RIM-it ose një auditori të pavarur të emëruar nga RIM akses në ambientet dhe kompjuterat ku përdoren ose janë përdorur Produktet, Shërbimet apo Programet e RIM dhe çdo të dhënë lidhur me këtë. Në këtë mënyrë Ju autorizoni RIM të bashkëpunoje me: (i) autoritetet ligjore mbi hetimin e shkeljeve kriminale të dyshuara; (ii) palët e treta në hetimin e shkeljeve të kësaj Marrëveshjeje; dhe (iii) administratorët e sistemit në ofrimin e shërbimit të internetit, rrjeteve apo pajisjeve të kompjuterit në mënyrë që të përforcohet kjo Marrëveshje. Një bashkëpunim i tillë mund të përfshijë që RIM të zbulojë emrin e Përdoruesit, adresën IP, apo informacione të tjera personale Tuajat ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar.

4. Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë. Në lidhje me përdorimin e Tuajit BlackBerry Solution, Ju mund të merrni ose siguronin akses në, Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë.

- (a) Artikujt e kërkuar të Palës së Tretë. Ju jeni përgjegjës për të siguruar së Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë (duke përfshirë, pa kufizim, sistemet kompjuterike, lidhje të Internetit, dhe Shërbimet Airtime) me të cilat Ju zgjidhet për të vepruar Tuajin BlackBerry Solution plotësojnë kërkesat minimale të RIM, duke

përfshirë, pa kufizim, shpejtësinë e përpunimit, memorien, programin e klientit dhe mundësinë e aksesit të dedikuar në Internet të nevojshëm për Tuajin BlackBerry Solution siç përcaktohet në Dokumentacion, dhe që Ju dhe Përdoruesit Tuaj të Autorizuar të përdorni keto Artikuj të Palës së Tretë dhe/ose Shërbimet e Palës së Tretë me Tuajin BlackBerry Solution nuk është në shkelje të asnjërës nga licencat, afatet, kushtet, ligjet, rregullat dhe/ose rregulloret duke respektuar përdorimin e këtyre Artikujve të Palës së Tretë dhe Shërbimeve të Palës së Tretë.

- (b) Shërbimet Airtime. Në shumicën e rastëve, Juaj BlackBerry Solution do të kërkojë një abonim për Shërbimet Airtime në mënyrë që të përdorni Tuajin BlackBerry Solution dhe Ju duhet ta merrni këtë abonim ndërmjet një Furnizuesi të Shërbimit Airtime (ose aty ku është në dispozicion përmes RIM në emër të një Furnizuesi të Shërbimit Airtime) Shërbimi Airtime i cili të jetë subjekt i afatëve dhe kushtëve të këtij Furnizuesi të Shërbimit Airtime. Nëse Ju dëshironi të merrni informacion në lidhje me se cilët Furnizues të Shërbimit Airtime mbështesin Tuajin BlackBerry Solution në vendin Tuaj, Ju lutem kontaktoni RIM nëpërmjet [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).
- (c) Shërbimet e kërkuara të Palës së Tretë. RIM mund gjithashtu t'ju sigurojë Ju me artikuj të Programit BlackBerry Handheld që janë projektuar posaçërisht për t'ju mundësuar Ju akses të veçantë në Shërbimet e Palës së Tretë (p.sh. My Space dhe MSN Messenger). Furnizuesi Juaj i Shërbimit Airtime duhet t'ju lejojë Ju që të keni akses në Shërbimet e Palës së Tretë përmes Produktit Tuaj Handheld në mënyrë që Ju ta bëni këtë. Ju gjithashtu mund të kërkonte një llogari Furnizuesit të Shërbimit të Palës së Tretë në mënyrë që të përdorni këtë Program Handheld BlackBerry me disa karakteristika të Shërbimit të Palës së Tretë, llogari e cila do të rregullohet nga afatet dhe kushtet që Ju pranoni në lidhje me Shërbimin Palës së Tretë.

Në qoftë se Ju nuk jeni të sigurt nëse RIM është burimi i faqeve të internetit, përmbajtjeve, artikujve, produktit apo shërbimit, ju lutem kontaktoni me RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com). Nëse Ju bëni marrëveshje me palë të treta nëpërmjet internetit ose në bashkëpunim me Shërbimet e Palës së Tretë, bëni kujdes të siguroheni që Ju e dini se me kë po bëni marrëveshje, dhe se i njihni kushtet e shoqëruara me ato faqe Interneti dhe të çdo Shërbimi të Palës së Tretë ose Artikuj të Palës së Tretë, Ju mund të merrni, duke përfshirë, pa kufizim shpërndarjen dhe kushtet e pagesës, kushtet e përdorimit, kushtet e licencës për përdoruesin fundor, aftësinë për të kthyer produktet, kushtet e privacisë, vendosjen e privacisë, dhe karakteristika sigurie për të mbrojtur informacionin Tuaj privat dhe për të siguruar sigurinë Tuaj personale. Nëse Ju hyni në marrëveshje me palë të treta, Ju do të mbani përgjegjësi për pajtueshmëri me kushtet dhe dispozitat e parashikuara në ato marrëveshje.

5. Kushtet Shtesë për Programet e Palës së Tretë dhe Përbërësit e Palës së Tretë. Pa u kufizuar nga e mësipërmja, Programet mund të përfshijnë Përbërës të Palës së Tretë, dhe për ta zgjeruar eksperiencën Tuaj me Tuajin BlackBerry Solution, Programi i Palës së Tretë mund të sigurohet në lidhje me Produktet RIM ose Programin kur është transportuar direkt nga RIM ose mund të transmetohet, shpërndahet apo t'ju mundësohet Juve herë pas here. Përdorimi Juaj i Përbërësve të Palës së Tretë dhe Programeve të Palës së Tretë (duke përfshirë përmirësimet dhe azhornimet) mund të jetë subjekt i kushteve të ndara apo plotësuesë. Keto kushte të ndara apo plotësuese do të jenë të dobishme në një material teksti që shoqëron programin dhe/ose, në rastin e Programit të Palës së Tretë, mund t'ju mundësohet kur Ju ta përdorni apo ta instaloni Programin e Palës së Tretë për herë të parë. Përsa i përket Programit të Palës së Tretë që ju sigurohet Juve nga RIM, RIM është i aftë t'ju sigurojë këtë program vetëm me kuptimin, njohjen dhe pranimin Tuaj se ky program është: (a) siguruar si një komoditet vetëm për Ju, dhe (b) nëse nuk është i

shoqëruar nga një licënsë programi të vecantë, i nënshtrohet kushteve dhe dispozitave të kësaj Marrëveshje si të ishtë Program, me përjashtim të të gjitha rastëve kur është siguruar nga RIM "AS IS" dhe "AS AVAILABLE" pa kushte të shprehura apo të nënkuptuara, përkrahje, vërtëtime, garanci, përfaqësime apo garancione. Nëse Ju dëshironi të merrni Programin e Palës së Tretë në kushte të tjera, Ju duhet ta merrni këtë Program të Palës së Tretë drejtpërdrejtë nga furnizuesi i tij. Në asnjë rast keto marrëveshje të veçanta të licënsës ose afate dhe kushte shtesë ndërmjet Jush dhe furnizuesit nuk do të jenë të detyrueshme për RIM ose të imponojnë ndonjë detyrim shtesë, ose detyrime në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, mbi RIM çfarë do qofshin. Për sa kohe që çdo Përbërës i Palës së Tretë mbulohet me afatet dhe kushtet shtesë që ju sigurojnë Juve të drejtat për ti përdorur, kopjuar, shpërndarë, apo modifikuar të gjithë ose një pjesë të këtyre Përbërësve të Palës së Tretë, që i tejkalojnë të drejtat që ju jepen Ju nga kjo Marrëveshje për Programin atëherë, vetëm për aq sa ju mund ti ushtroni këto të drejta më të gjëra pa shkelur kushtet e kësaj Marrëveshjeje për pjesën e mbetur të Programit, Ju i përfitoni keto të drejta me të gjëra.

6. Mbështetje Kriptografike e Desktop-it. Programi BlackBerry Handheld mund të përfshijë module të programit që lejojnë përdoruesit të zgjerojnë disa prej implementimeve kriptografike egzistuesë të bazuara në desktop (siç është S/MIME Versioni 3.0 (ose pasues) ose implementime të bazuara në standartet RFC 2440, siç është PGP) (secili një "Implementim i Kriptografisë së Desktop-it") pa kabell për disa Produkte Handheld. Disa implimentime të Kriptografisë të Desktop-it mund të kërkojnë nga ju që të pajiseni fillimisht me keto Implimentime të Kriptografisë të Desktop-it nga një palë e tretë shitësi. RIM nuk siguron ndonjë pjesë të infrastrukturës së kriptografisë së kërkuar për Implementimin e Kriptografisë së Desktop vetë dhe RIM nuk merr asnjë përgjegjesi për përzgjedhjen, përvetësimin, implementimin, performancën ose jo-përformancën, mbështetjen, përpikmërinë ose sigurinë e ndonjë pjese të infrastrukturës Tuaj kriptografike, duke përfshirë, pa kufizim, përzgjedhjen, përvetësimin, saktësinë ose besueshmërinë e infrastrukturës së programit ose ndonjë firme besimi, çelësve publik, çertifikata të palëve të treta dhe shërbime të lidhura me to, ose ndonjë vërtetim ose metode vërtetimi, e përdorur në lidhje me infrastrukturen e kriptografisë. Ju jeni përgjegjës të siguronit që Ju pajtoheni me afatet dhe kushtet, rregullat dhe rregulloren duke respektuar përdorimin Tuaj të infrastrukturës së kriptografisë së zbatuar, çertifikatave, çelësve publike, dhe ndonjë shërbimi apo programi tjetër që Ju mund ta përdorni në lidhje me Implementimin Tuaj të veçantë të Kriptografisë në Desktop. RIM NUK KA ASNJË PËRGJEGJËSI PËR ÇFAREDOLLOJ PROBLEMI QË VJEN NGA OSE NË LIDHJE ME IMPLEMENTIMIN TUAJ TË KRIPTOGRAFISË NË DESKTOP.

7. Pronësia Intelktuale. As Ju dhe as Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk përfitoni me këtë rast ndonjë të drejtë pronësie, titull ose interes në ose me ndonjë pronësi intelektuale ose të drejta të tjera pronësie, duke përfshirë patenta, dizenjimet, shenjat dalluese, copyright, të drejtat e databasë apo të drejtat në ndonjë informacion konfidencial ose sekret tregtar, në ose në lidhje me Tuajin BlackBerry Solution apo ndonjë pjese të tij. Ju gjithashtu nuk përfitoni ndonjë të drejtë të licënsës në ose në lidhje me Tuajin BlackBerry Solution apo ndonjë pjese të tij, përveç të drejtave të licënsuara shprehimisht në bazë të kësaj Marrëveshjeje apo të ndonjë marrëveshjeje reciproke që mund të keni bërë me RIM me shkrim. Asnjë titull dhe/ose e drejtë pronësie mbi produktet e RIM-it (nëse ka) nuk jepen në bazë të kesaj Marrëveshjeje. Çdo e drejtë e cila nuk është dhënë shprehimisht këtu është shprehimisht e rezervuar. Për qartësi, pavarësisht nga çdo gjë tjetër në këtë Marrëveshje, në asnjë rast licënsat e dhëna në Programin sipas kësaj kontrate zgjeron, ose të interpretohen sikur zgjeron, me përdorimin e çdo Shërbimi të Palës së Tretë ose të Artikujve të Palës së Tretë qoftë në një bazë të pavarur ose në lidhje me Tuajin BlackBerry Solution, dhe, pa u kufizuar nga sa më sipër, në asnjë rast licënsat e dhëna më poshtë do të interpretohen në mënyre të tillë që çdo furnizues i këtyre Shërbimeve të Palës së Tretë ose të Artikujve të Palës së Tretë të jetë në gjendje që me sukses të pohojë së përdorimi i këtyre Shërbimeve të Palës së Tretë ose të Artikujve të Palës së Tretë qoftë në lidhje me të gjitha ose një pjesë

e BlackBerry Solution ose në një bazë të pavarur janë të licensuara nën patentat e RIM për shkak të faktit së Programi është i licencuar mëposhtë. Programi, duke përfshirë ndonjë kopje që Ju i bëni Programit, vetëm licensohet dhe nuk ju shitet, Ju-ve, dhe Programi, gjithë dokumentacioni dhe ndonjë faqë interneti që ju lejon Ju-ve të keni akses në shërbimet mbrohen nga legjislacioni i Kanadasë, Shteteve të Bashkuara dhe nga dispozitat ndërkombëtare për të drejtën e autorit dhe patenta dhe traktatet ndërkombëtare. Ka dënime të rënda si civile ashtu edhe penale për shkelje të pronës intelektuale. Ju bini dakort së asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të ndikojë negativisht në të drejtat dhe kërkesën për zhdëmtim, duke përfshirë pa kufizim, çdo urdhër lehtësues, që RIM mund të ketë në bazë të ligjeve në fuqi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronësisë intelektuale të RIM ose të drejtat tjera të pronësisë.

8. Cisco Non-assert Pass-through. Nëse Juaji BlackBerry Solution përmban ndonjë Teknologji Cisco, përsa i përket të drejtës Tuaj të përdorimit të Teknologjisë Cisco, Ju bini dakord të mos kërkonin ndonjë të drejtë patentë lidhur me teknologjinë Cisco kundrejt Cisco, klientëve të Cisco, distributorëve Cisco ose të licensuarve të Teknologjisë Cisco për të bërë, ta kenë bërë, përdorur, shitur, ofruar për të shitur, apo për të importuar produkte që përshtaten ose implementojnë Teknologjinë Cisco. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, "Teknologjia Cisco" do të thotë programi, Protokollin e Vërtetimit të Rritjes së Peshës së Lehtë ("LEAP"), specifikimet e LEAP, teknologjia e Zgjeruar e Klientëve Cisco, informacioni teknik dhe algoritmi, siç vetëm ata lidhen me LEAP dhe/ose Zgjerimin e Klientëve Cisco, sipas nevojës.

9. Kufizimet e Eksportimit, Importimit dhe Përdorimit dhe Licensat e Qeverisë të SH.B.A.

- (a) Ju e dini se Produktet e RIM dhe Programi përfshijnë teknologjinë kriptografike i cili mund të jetë subjekt i eksportit, importit dhe/ose kontrolleve nga Autoritetet Qeverisëse (siç është përcaktuar me poshtë) me anë të ligjit dhe legjislacionit. Ju bini dakord që produktet dhe Programet e RIM nuk do të eksportohen, importohen, të përdoren, transferohen apo të ri-eksportohen përveç se në përputhje me ligjin dhe rregullat e autoriteteve kombëtare dhe/ose autoriteteve të tjera qeveritare (nënkombëtare dhe/ose mbikombëtare) me autoritet në vendin(et) dhe/ose territorin(et) nga të cilët po eksportohen Produktet dhe Programet e RIM apo Produktet dhe Programet e RIM po importohen (së bashku, "Autoritet(et) Qeverisëse"). Pa kufizim, ju bini dakort që Produktet dhe Programet RIM nuk do të eksportohen: (i) drejt çdo vendi të listës së kontrollit të zonës së Kanadasë; (ii) drejt çdo vendi i cili është subjekt i embargos së Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara; (iii) në kundërshtim me listën e artikujve të kontrollit të eksportit Kanadez 5505; (iv) në vende që i nënshtrohen sanksioneve të SH.B.A. dhe të embargos ekonomike; dhe (v) personave ose enteve të ndaluar për marrjen e eksporteve amerikane apo artikujve me origjinë amerikane. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Pikë, ju lutem kontaktoni me RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com). Në këtë mënyrë Ju deklaroni se; (A) për aq sa keni njohuri Ju jeni të ligjshëm të merrni Produktet RIM dhe Programin sipas ligjit në fuqi, (B) Ju nuk do të përdorni Produktet dhe Programin e RIM në zhvillimin, prodhimin, trajtimin, mirëmbajtjen, depozitimin, prishjen, identifikimin dhe përhapjen e armëve nukleare, kimike apo biologjike, apo në sistemet e shpërndarjes së raketave, apo të materialeve ose pajisjeve që mund të përdoren në ato armë apo në sistemet e tyre të shpërndarjes së raketave, apo ti rishisni ose ti eksportoni ndonjërit ose ndonjë entit të përfshirë në këtë aktivitet; dhe (C) Ju do të siguronit së Përdoruesit e Autorizuar përdorin produktin(et) dhe Programet e RIM-it në përputhje me përkufizimet e lartpërmendura. Pavarësisht nga çdo marrëveshje me një palë të tretë ose ndonjë dispozitë ligjore, rregull apo politike, nëse Ju jeni ndonjë agjensi e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, atëherë të drejtat e Juaja në lidhje me Programin nuk do të tejkalojnë të drejtat e paraqitura në këtë Marrëveshje, përveç nëse

shprehimisht e pranuar nga RIM në një marrëveshje të shkruar ndërmjet Jush dhe RIM-it dhe të firmosura nga një Nëpunës Drejtues Operativ ose Drejtues Ekzekutiv i RIM.

- (b) Ju në këtë menyrë bini dakord të demshpërbleni RIM-in, Grupin e Kompanive RIM dhe Furnizuesin e Shërbimit Airtime nga çdo kërkesë, veprime, detyrime apo shpenzime (duke përfshirë tarifat dhe shpenzime të arsyeshme të avokatëve) që rezultojnë nga deshtimi Juaj për të vepruar në përputhje me njohuritë, marrëveshjet dhe përfaqësimet në këtë Pikë.

10. Siguria. Juaji BlackBerry Solution mund të përdorë një nivel sigurimi të dhënave të inkriptuara për komunikime ndërmjet Produktit Tuaj Handheld dhe sistemit të kompjuterit me të cilin vepron. Ju bini dakord të merrni përgjegjësinë e plotë për vendosjen e masave të plota të sigurisë për të kontrolluar aksesin në Produktin Tuaj Handheld dhe ketij sistemi të kompjuterit.

11. Konfidencialiteti dhe Asnjë Ndryshim Inxhinierik. Ju pranoni dhe bini dakord së Programi ishte: (a) zhvilluar në kohë dhe shpenzime të konsiderueshme nga RIM dhe/ose Grupi i kompanive RIM; dhe (b) që programi dhe CAL në lidhje me të përmban informacion konfidencial duke përfshirë sekrete tregtare të RIM-it, Grupit të kompanive të RIM dhe furnizuesit e tyre përkatës. Kjo marrëveshje nuk ju jep Juve asnjë të drejtë të merrni nga RIM apo distributorët e tij ndonjë kod burim për Programin, dhe, përveç për aq sa RIM është shprehimisht i ndaluar me ligj për të ndaluar keto veprime, Ju bini dakord se as Ju as Përdoruesit Tuaj të Autorizuar nuk do të shndërrojnë, modifikojnë, adaptojnë, krijojnë punë të prejdhura, përkthejnë, demtojnë, apo të Ndryshojnë Inxhinierinë e Programit dhe/ose CAL-et në lidhje me të, apo tentojnë të veprojnë kështu, ose lejojnë, pranojnë në heshtje, autorizojnë apo inkurajojnë ndonjë palë tjetër për të vepruar kështu. Për qëllimin e kësaj marrëveshje "Ndryshimi Inxhinierik" përfshin çdo veprim të ndryshimit inxhinierik, përkthimin, çmontimin, mospërpilimin, dekriptimin, apo dekonstruktimin (duke përfshirë çdo aspekt të "zbrasjes së RAM/ROM ose ruajtje e vazhdueshme", "përgjim e me kabëll ose pa kabëll", ose "kutia e zezë" e ndryshimit inxhinierik) e të dhënave, program-in, (duke përfshirë ndërfaqe, protokolle dhe ndonjë të dhënë tjetër të përfshirë apo të përdorur në bashkëpunim me programet që mund ose mund të mos konsiderohen teknikisht kode programi) shërbimin, apo hardware ose ndonjë metode apo proces të marrjes ose konvertimit të ndonjë informacioni, të dhënë apo programi në një formë të lexueshme.

12. Afati. Kjo marrëveshje do të jetë efektive sapo Ju të bini dakord të pajtoheni me kushtet e kësaj Marrëveshje (siç përshkruhet në parathënien e mësipërme) dhe do të vazhdojë efektshmërinë përveç nëse përfundon në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

Pavarësisht nga e mësipërmja, nëse pas bërjes Tuaj palë në këtë Marrëveshje, RIM transmeton ose ndryshe bën të disponueshëm për Ju, ndonjë Program BlackBerry Handheld shtesë që është falas dhe është projektuar për t'ju mundësuar Ju që të keni akses në Shërbimet e Palës së Tretë, atëherë, për shkak të sigurisë që ka Programi Handheld BlackBerry në Shërbimet e Palës së Tretë, RIM ruan të drejtën, por nuk ka detyrim, për të përfunduar licencën Tuaj për këtë Program BlackBerry Handheld falas, në çdo kohë, për çfarëdo arsye, pa Ju njoftuar, sidoqoftë, nëse është e realizueshme, RIM do të përdor përpjekje të arsyeshme tregtare për t'ju vënë në dispozicion Ju me njoftimin e përfundimit.

13. Kompesimi dhe Përfundimi për Mospagim.

- (a) Nëse Ju apo Përdoruesit Tuaj të Autorizuar e shkelni këtë Marrëveshje, RIM mund, përveç të gjitha të drejtave të tjera dhe kompensimeve të siguruar nga kjo Marrëveshje ose me ligj, menjëherë të përfundojë këtë Marrëveshje dhe ndonjë marrëveshje license ndërmjet Jush dhe RIM për çdo pjesë tjetër të Tuajit BlackBerry Solution të përdorur nga Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar me Programin; dhe/ose të mos ju sigurojë Juve ose Përdoruesve Tuaj të Autorizuar ndonjë Shërbim(e) në

lidhje me Tuajin BlackBerry Solution. Kur Ju ti keni dhënë RIM informacion të saktë kontakti, RIM do t'ju sigurojë Ju me njoftimin e përfundimit.

- (b) Pa u kufizuar në përmbajtjen e fjalisë paraprake, do të konsideroheni që jeni në shkelje të kësaj Marrëveshje dhe RIM do të ketë të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje duke ju njoftuar, nëse:
- (i) Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar dështoni të përmbushni apo zbatoni një afat ose kusht këtu;
  - (ii) Ju materialisht shkelni çdo marrëveshje tjetër licënsimi ose kushtet e shërbimit që Ju mund të keni me RIM për çdo pjesë të Tuajin BlackBerry Solution të përdorur nga Ju ose Përdoruesit Tuaj të Autorizuar me Program, duke përfshirë, pa kufizim, kushtet e ndonjë click-wrap ose shrink-wrap marrëveshje që Ju keni rënë dakord në një faqe interneti të RIM ose ndryshe;
  - (iii) Ju ose ndonjë nga Përdoruesit Tuaj të Autorizuar ndërhyjni në shërbimin e klientit të RIM-it ose në operacionet e biznesit; ose
  - (iv) çdo tarifë mujore ose tarifë tjetër periodike apo shpenzimet e lidhura me përdorimin Tuaj të Tuajit BlackBerry Solution nuk është paguar brenda (30) ditëve nga data që janë bërë të pagueshme.
- (c) Vec kësaj, RIM mund të përfundojë këtë Marrëveshje dhe/ose menjëherë të ndërpresë ofrimin e shërbimit (eve) pa asnjë detyrim ndaj Jush apo Personave Tuaj të Autorizuar nëse RIM është ndaluar në ofrimin e ndonjë pjesë apo të gjithë Shërbimit ose të shes Shërbimit Airtime, nëse aplikohet, nga ndonjë ligj, rregullore, kërkesë apo vendim të lëshuar në çfaredolloj forme nga organi gjyqësor apo organ tjetër qeveritar, ose nëse një njoftim nga një agjensi qeveritare apo departament tregon se RIM ose Furnizuesi i Shërbimit Airtime nuk lejohet të ofrojë ndonjë pjesë ose të gjitha Shërbimet Airtime, nëse është e aplikueshme.
- (d) Asgjë këtu nuk do të interpretohet që ti kërkojë RIM-it të heq dorë nga çdo ligj i tillë, rregull, rregullore apo kufizim, ose të kërkojë rishikim gjyqësor apo apelim për ndonjë vendim gjyqësor. RIM nuk do të ketë asnjë përgjegjësi kundrejt Jush ose Përdoruesve Tuaj të Autorizuar që rrjedh apo është e lidhur me zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me këtë Pikë.
- (e) Nëse Ju shkelni, shpërdoroni ose ndryshe prishni informacionin konfidencial të RIM-it, pronësinë intelektuale ose të drejta të tjera pasurore (së bashku, "Shkelja e Pronësisë Intelektuale") dhe një gjykatë në Shqipëri nuk është në gjendje apo nuk ka ndërmend të jap një vendim gjyqësor për të ndaluar këtë Shkelje të Pronësisë Intelektuale, Ju pranoni se RIM do të ketë të drejtë të marrë dëmet e likuiduara nga Ju në shumën prej US \$ 5,000 në ditë gjatë periudhës së kësaj shkelje të Pronësisë Intelektuale.

14. Pasoja e Zgjidhjes. Me zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht si është shkaktuar, ose nëse abonimi Juaj ose periudha e përdorimit falas për Programin skadon: (a) Ju do të ndërprisni menjëherë çdo përdorim të Programit (ose artikuj të Programit për të cilin licënsa ka skaduar) dhe të ktheni të gjitha kopjet e këtij Programi që janë në posedimin ose kontrollin Tuaj dhe/ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar; dhe (b) RIM do të ketë të drejtën të bllokojë

transmetimin e të dhënave tek dhe nga ky Program pa ju njoftuar Juve. Me përfundimin e çdo llogarie që Ju mund të keni me RIM, Ju autorizoni RIM të fshijë çdo dosje, programe, të dhëna dhe mesazhe mail-i të lidhura me këtë llogari, pa ju njoftuar Juve. Në rastin e zgjidhjes të kësaj marrëveshje nga RIM në vijim të dispozitave të kësaj Marrëveshje, Ju do ti paguani RIM-it të gjitha pagesat (duke përfshirë pagesat dhe shpenzimet e arsyeshme për avokatët) dhe shpenzime të lidhura të bëra ose të kryera nga RIM në ekzekutim të të drejtave të tij si mëposhtë). Pavarësisht nga sa mësipër, për shkak të natyrës së Programit, mund të jetë e pamundur për të kthyer Programin për shkak se Programi është i integruar në hardwarin që keni në pronësi (të tilla si një Produkt Handheld) dhe/ose Programi mund të jetë i instaluar në një desktop apo një server në mënyrë të tillë që gjithcka që ju mund të ktheni është një riprodhim i mëtejshëm i Programit. Në raste të tilla, ju lutem kontaktoni RIM në [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com) për udhëzime të mëtejshme.

15. Demshpërblimi/Përgjegjësia. Ju duhet të mbron, dëmshpërbleni, dhe të ruani të padëmtuara RIM-in, Kompanitë e Grupit RIM, filialet e RIM-it, furnizuesit, trashëgimtarët, agjentët, distributorët e autorizuar dhe të atribuoni dhe çdonjërit prej drejtorëve, zyrtarëve, nënpunësve dhe kontraktuesve të pavarur (secila një "Pale Demshpërbluese e RIM") ndonjë pretendim, dëmtim, humbje, kosto apo shpenzime (duke përfshirë, pa kufizim, pagesat dhe shpenzimet e arsyeshme për avokatët) të shkaktuara nga një Palë Dëmshpërbluese e RIM-it si rrjedhojë e : (a) shkeljes së patentave apo të ndonjë të drejtë tjetër të pronësisë intelektuale apo të drejtë pasurore për shkak të kombinimit apo përdorimit të ndonjë pajisjeje (të ndryshme nga një Produkt Handheld), sistemi ose shërbimi të lidhur me Tuajën BlackBerry Solution apo ndonjë pjesë të tij; (b) dëmtimeve që vijnë nga shkelja e ndonjërit prej Pikave të Marrëveshjes: "Mbështetje Kriptografike të Desktopit" (Pika 6), "Përdorimi i Tuajit BlackBerry Solution" (Pika 3), "Liçensa e Programit dhe Dokumentacionit" (Pika 2), "Artikujt e Kërkuar të Palës së Tretë" (Pika 4(a)), "Shërbimet Airtime"(Pika 4(b)), "Shërbimet e Kërkuara të Palës së Tretë" (Pika 4(c)), "Pronesia Intelektuale" (Pika 7), "Kufizimet e Eksportimit, Importimit dhe Përdorimit dhe Liçensat e Qeverisë të SH.B.A". (Pika 9), "Konfidencialiteti dhe Asnjë Ndryshim Inxhinierik" (Pika 11); (c) çdo plagosjeje, vdekje ose dëmtimi të pronës që vjen nga neglizhenca apo keqpërdorimi në lidhje me përdorimin Tuaj ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar të Tuajit BlackBerry Solution apo ndonjë pjesë të tij nga Ju apo Përdoruesit Tuaj të Autorizuar ; ose (d) pretendimeve të ngritura nga palët e treta kundrejt RIM-it, që rrjedhin nga ose janë të lidhura me përdorimin Tuaj ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar të Programeve ose të Tuajit BlackBerry Solution ose ndonjë pjesë të tyre (përveç këtyre pretendimeve që lindin vetëm nga përdorimi i Produkteve RIM, Programeve dhe/ose të Shërbimeve të parashikuara nga dhe totalisht në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumentacionit i cili në mënyrë specifike përkon me këtë version të Programeve dhe/ose të Produkteve RIM). Asnjë kompensim sipas kësaj Marrëveshjeje i akorduar RIM-it nuk ka për qëllim të jetë, dhe as nuk do të mund të interpretohet sikur është ekskluzive i ndonjë kompensimi tjetër të parashikuar në këtë Marrëveshje ose ashtu siç lejohet me ligj ose nga praktika gjyqësore, por të gjitha keto lloj kompensimesh do të jenë kumulative.

16. Garancitë e Kufizuara.

(a) Programi.

(i) Nëse gjatë një periudhe (90) ditore pas shpërndarjes së Programit tek Ju ("Periudha e Garancisë"), Programi i mundësuar nga RIM apo çdo distributor i autorizuar i RIM-it nuk është në gjendje të kryejë funksionet e përshkuara në Dokumentacionin standart të Përdoruesit Fundor ("Specifikimet") kur përdoret siç është specifikuar nga RIM në Dokumentacion e aplikueshëm për llojin dhe versionin specifik të Programit në lidhje me pjesët e tjera të pandryshueshme të Tuajit BlackBerry Solution, RIM duke vendosur e

zgjedhur vetë, ose do të bëjë përpjekje për t'i korrigjuar apo t'ju jap Juve një zgjidhje të ketij problemi (cilin rregullim apo riparim do t'ju ofroje sipas gjykimit të arsyeshëm të RIM-it në një nga format e shumëllojshme, duke përfshirë këtu dhe mbështetjen e klientit që ju jepet Ju me telefonata ose e-maile, zhbllokimin dhe rregullimin e programit të vënë përgjithësisht në dispozicion, në faqen e internetit të RIM ose në ndonjë formë tjetër të cilën RIM-i Jua këshillon) ose t'ju ofroj një kompensim për tarifën e paguara një herë nga Ju për Programin e aplikueshem nëse Ju ndërprisni përdorimin e Programit dhe mjetet në të cilat Programi Ju është dhënë Juve dhe të gjitha paketimet në lidhje me të i kthehen RIM-it në përputhje me mekanizmin e kthimit normal të garancisë (i cili mund të jetë nëpërmjet Furnizuesit tuaj të Shërbimit Airtime, nëse e mundshme, ose në piken e shitjes) brenda Përiudhës së Garancisë së bashku me provën e blerjes.

- (ii) Pavarësisht nga çdo gjë që bie në kundërshtim me këtë Marrëveshje, azhornimet, dhe përmirësimet që Ju janë ofruar falas janë dhënë "AS IS" dhe pa asnjë lloj garancie.
- (iii) Azhornimet dhe Përmirësimet, për të cilat Ju keni paguar tarifën shtesë të licencës do të jenë objekt i garancisë të vendosur me sipër për një përiudhë nëntëdhjetë(90) ditore që prej datës që ky përmirësim për çdo Program ju është dhënë Juve.
- (iv) Detyrimi i mesipërm nuk do të zbatohet nëse deshtimi i Programit për të kryer funksionet e përshkruara në Specifikimet vjen si pasojë e : (A) Përdorimit të Programit në mënyre kontradiktore me çdo detyrim Tuajin të përshkruar në Pikat e kësaj Marrëveshje të titulluar, "Artikujt e kërkuar të Palës së Tretë" (Pika 4(a)), "Shërbimet Airtime" (Pika 4(b)), "Shërbimet e Kërkuara të Palës së Tretë" (Pika 4(c)), "Mbështetje Kriptografike e Desktop-it" (Pika 6), "Përdorimi i Tuajës BlackBerry Solution" (Pika 3), " Licënsa e Programit dhe Dokumentacionit " (Pika 2), "Kufizimet e Eksportimit, Importimit dhe Përdorimit dhe Licënsat e Qeverisë të SH.B.A". (Pika 9) apo "Konfidencialiteti dhe Asnjë Ndryshim Inxhinierik" (Pika 11) apo në një mënyrë kontradiktore me udhëzimet, duke përfshirë udhëzimet e sigurisë, të specifikuar nga RIM në Dokumentacionin përkatës për llojin dhe versionin specifik të Program-it; ose (B) një mosfunksionim apo një problem tjetër i lidhur me çdo hardware (duke përfshirë ato që rrjedhin nga Produktet Handheld difektoze të Palës së Tretë), rrjet, program apo sistem komunikimi të ndryshëm nga pjesët e tjera të Tuajës BlackBerry Solution; ose (C) ndaj çdo shkakut të jashtëm që ndikon në Program, duke përfshirë mjetet në të cilat ju është dhënë Programi, siç është aksidenti, shkatërrimi, goditja elektrostatische, zjarri, përmbytja, vetëtimat, uji ose era, korrigjimi i gabimeve që i atribuohen programit përveç Programit, apo difekte të bëra si pasojë e riparimeve apo modifikimeve jo të autorizuara nga RIM.
- (v) Për sqarim, përveç nëse kërkohet ndryshe nga ligji në fuqi, kjo garanci vlen për Programin BlackBerry Handheld në Produktët e reja Handheld, dhe nuk zbatohet për Programin BlackBerry Handheld të përfshirë me Produktet Handheld të përdorura apo të rinovuara.

- (vi) Nuk ka garanci për shkarkimet falas nga tregu i artikujve shtesë të Programit (që përbëjnë përmirësime të Programit bazë i marrë me Produktin Handheld), ose për Programin falas të Serverit. Nëse ndonjë pikë e këtij Programi nuk funksionon në përputhje me Dokumentacionin e saj brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas datës që Ju e instaloni atë në Produktin Tuaj Handheld apo kompjuter sipas rastit, Ju mund të kontaktoni RIM dhe RIM do të identifikojë mbështetjen, e mundshme, nëse ka për këtë Program (mbështetje e cila mund t'Ju ofrohet me vendim të RIM-it në një nga format e ndryshme, duke përfshirë ketu mbështetjen e klientit me telefonata dhe e-maile që ju sigurohet Ju, zhbllokimin dhe rregullimin e programit të vënë përgjithësisht në dispozicion, në faqen e internetit të RIM ose në ndonjë formë tjetër të cilën RIM Jua këshillon).
  - (vii) Ju pranoni dhe bini dakort që Ky Program është projektuar për të lehtësuar aksesin Tuaj në Artikujt e Palës së Tretë ose në Shërbimet e Palës së Tretë, RIM MUND TË KETË KONTROLL TË KUFIZUAR OSE JO MBI FUNKSIONALITETIN APO PËR EFIKASITETIN OSE-JO TË KËTYRE ARTIKUJVE TË PALËS SË TRETË OSE SHËRBIMEVE TË PALËS SË TRETË, DHE MUND TË MOS JETË NË GJENDJE TË OFROJË REGULLIMIN OSE RIPARIMIN PËR NJË PROBLEM QË JU IDENTIFIKONI ME KËTË PROGRAM.
  - (viii) Kjo Pikë përcakton detyrimet e vetme të RIM-it dhe kompensimin Tuaj të vetëm në lidhje me Programin dhe çdo difekt, gabim, problem, ose shkelje të garancisë për Programin e përcaktuar këtu.
- (b) Produkt(et). Garancia e kufizuar, nëse ka, për produkt(et) RIM ("Garancia e Kufizuar e Produktit") është dërguar në Dokumentacionin përkatës. Garancia e Kufizuar e Produkteve është garancia ekskluzive për çdo Produkt RIM të shitur nën kushtet e kesaj Marrëveshje dhe përcakton kompensimet e vetme Tuaja përsa i përket produkteve RIM dhe çdo shkelje të Garancisë së Kufizuar të Produktit. Nën-pikat e mëposhtme të Pikës së kësaj Marrëveshje të titulluar "Të përgjithshme" (Pika 26) me poshtë janë përfshirë duke iu referuar kushteve të Garancisë së Kufizuar të Produktit, e modifikuar sipas kërkesës për aq sa është e nevojshme për t'u aplikuar në Garancinë e Kufizuar të Produktit: "Heqja dorë nga mospërbushja e detyrimeve" (Pika 26(b)), "Mbijetesë" (Pika 26(c)), "Pavlefshmëria" (Pika 26(e)), "Gjuha" (Pika 26(f)) dhe "Marrëveshja në Tërësi" (Pika 26(h)). Duke dhënë pranimin Tuaj të kësaj Marrëveshje siç është paraqitur me sipër, Ju pranoni së keni lexuar Garancinë e Kufizuar të Produktit dhe bini dakort me kushtet e saj. Për qartësim, përveç deri në masën e kërkuar nga ligji në fuqi, "Garancia e Kufizuar e Produktit" zbatohet vetëm për Produkt(et) e reja të RIM dhe vetëm bilanci i garancisë të tillë (nëse ka), zbatohet mbi çdo Produkt (et) të rinovuar të RIM-it .

17. Mbështetje Pas-Garancije. Nëse Ju dëshironi të merrni mbështetje nga RIM pas mbarimit të periudhës së garancisë, ju lutem kontaktoni RIM në sales@blackberry.com(ose në vende të tilla të tjera të listuara në <http://www.blackberry.com/legal/>) ose Furnizuesin Tuaj të Shërbimit Airtime. Nëse Ju keni një palë të tretë që drejton Programin në emrin Tuaj (një "Palë Drejtuese") dhe Ju dëshironi që Pala Drejtuese të marrë mbështetje për Programin nga RIM në emrin Tuaj, atëherë qoftë Ju ose Pala Drejtuese duhet të keni një marrëveshje mbështetjeje në vend me RIM-in për Artikuj të vecantë të Programit siç kërkohet për numrin Tuaj të Përdoruesve të Autorizuar, dhe Ju duhet të azhironi RIM-in herë pas here për sa i përket Programit të drejtuar në emrin Tuaj duke dërguar një e-mail tek

sales@blackberry.com (ose në vende të tjera të listuara <http://www.blackberry.com/legal/>) duke identifikuar Programin, numrin e kopjeve që Ju keni licënsuar, së bashku me ID-SRP dhe CAL. Asistenca për Tuajin BlackBerry Solution mund të mos disponohet përmes disa Furnizuesish të Shërbimit Airtime.

18. Kërkesat për kopje rezervë/shuarje të të dhënave. RIM rekomandon që Ju të bëni kopje rezervë të rregullta të gjitha emaileve, përmbajtjes, Programeve të Palës së Tretë që Ju bleni dhe/ose të dhëna të tjera mbi Produktin Tuaj Handheld, pasi keto të dhëna nuk ruhen apo nuk bëhen kopje rezerve nga ose në emër të RIM. Nëse Ju transferoni Produktin Tuaj Handheld për çfarëdo arsye, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me shërbimin e Produktit Tuaj Handheld, Ju duhet të fshini të gjitha të dhënat nga Produkti Juaj Handheld, dhe të heqni të gjitha memoriet e zgjeruara, apo këto të dhëna do të jenë të disponueshme për personin që merr Produktin Handheld, dhe Ju duhet të ri-instaloni çdo program që nuk ishte dërguar fillimisht me Produktin Handheld.

19. Refuzim.

LIGJI I DISA JURIDIKSIONEVE MUND TË MOS LEJOJË KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSISË OSE PËRJASHTIMIN E GARANCIVE, KUSHTEVE, MIRATIMEVE, GARANCITË, OSE PËRFAQËSIME NË KONTRATAT ME KONSUMATORET DHE PËR AQ SA JU JENI KONSUMATORE KËTO PËRJASHTIME MUND TË MOS APLIKOHEN PËR JU.

(a) Garancitë e Përgjithshme

(i) DËRI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT NË FUQI, ME PËRJASHTIME TË PËRCAKTUARA SHPREHIMISHT NË KËTË MARRËVESHJE, TË GJITHA KUSHTET, MIRATIMET, GARANCITË, PËRFAQËSIMET, OSE GARANCITË E ÇFAREDO LLOJI, TË SHPREHURA OSE TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRE PA KUFIZIM, ÇDO KUSHT, MIRATIM, GARANCI, PËRFAQËSIME OSE GARANCI TË QËNDRUESHMËRISË, PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR OSE, PËRDORIM, TË SHITJES, TË CILËSISË SË SHITJES, TË MOS SHKELJES, TË CILËSISË SË KENAQSHME, OSE TË TITULLIT, OSE QË RRJEDHIN NGA NJË LIGJ OSE ZAKON TREGTAR, DHE TË GJITHA GARANCITË E TJERA, PËRFAQËSIMET, KUSHTET, MIRATIMET OSE GARANCITË TË ÇFAREDO LLOJI QOFTË TË SHPREHUR APO TË NËNKUPTUAR, JANË TË REFUZUARA DHE TË PËRJASHTUARA DËRI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT TË ZBATUESHEM.

(ii) Deri në masën maksimale të lejuar sipas ligjit në fuqi, të gjitha garancitë e nënkuptuara ose kushtet lidhur me Programet për aq sa ata nuk mund të përjashtohen siç është përcaktuar më lart, por mund të jenë të kufizuar, janë të kufizuar me këtë rast për nëntëdhjetë (90) ditë që nga data që Ju keni instaluar ndonjë pjesë të Tuajit BlackBerry Solution në çdo kompjuter.

(b) Shërbim(et).

(i) PËRVEC RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI I ZBATUESHEM, ÇDO SHËRBIM OFROHET OSE KA AKSES "AS IS" DHE "AS AVAILABLE", PA KUSHTE, MIRATIME, PËRFAQËSIME OSE GARANCI TË ÇDO LLOJI NGA RIM.

(ii) RIM NUK GARANTON APO OFRON NJË SIGURIM TË NGJASHËM PAVARËSISHT PËRDORIMIT TË PANDËRPRERË OSE OPERIMI TË

ÇDO SHËRBIMI, VAZHDIMËSINË E VLEFSHMËRISË SË ÇDO SHËRBIMI, OSE QË ÇDO MESAZH, PËRMBAJTJE OSE INFORMACION QË ËSHTË DËRGUAR NGA JU OSE TEK JU DO TË JETË KORREKT, I TRANSMETUAR NË FORME TË SAKTË OSE BRENDA NJË PERIUDHË KOHE TË ARSYESHME.

- (c) Artikujt e Palës së Tretë dhe Shërbimet e Palës së Tretë, Faqe të lidhura me to.
- (i) PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI NË FUQI, SHËRBIMET E PALËVE TË TRETA DHE ARTIKUJT E PALËVE TË TRETA NUK JANË NË KONTROLLIN E RIM, RIM NUK APROVON NDONJË ARTIKULL TË VECANTË TË PALËS SË TRETË APO SHËRBIM TË PALËS SË TRETË, DHE RIM NUK KA ASNJË PËRGJEGJESI PËR ZGJEDHJEN TUAJ, PËRDORIMIN, AKSESIN, APO IMPLEMENTIMIN TË SHËRBIMEVE OSE ARTIKUJVE TË PALËS SË TRETË.
  - (ii) SA ME SIPËR APLIKOHET PAVARËSISHT NGA: (A) SI KENI PËRFITUAR APO SI KENI MARRË AKSES NË ARTIKUJT E PALËS SË TRETË DHE/OSE NË SHËRBIMET E PALËS SË TRETË, P.SH. NËSE NË MENYRE TË PAVARUR, APO NDËRMJET RIM-IT OSE FURNIZUESIT TUAJ AIRTIME, (B) NËSE NDONJË NGA ARTIKUJT E PALËS SË TRETË OSE SHËRBIMET TË PALËS SË TRETË (DUKE PËRFSHIRË SHËRBIMET AIRTIME) JANË KËRKUAR NË MËNYRË QË TË PËRDORNI TË GJITHA OSE NDONJË PJESË TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION; OSE (C) JU KENI MARRË OSE PËRFITUAR AKSES NË KETO ARTIKUJ TË PALËS SË TRETË DHE SHËRBIME TË PALËS SË TRETË ME ANË TË PRODUKTIT HANDHELD, DUKE PËRFSHIRE PA KUFIZIM, NËPËRMJET SHFLETUESIT APO PROGRAMIT BLACKBERRY WORLD APP QË MUND TË JEPET SI PJESË E PROGRAMIT BLACKBERRY HANDHELD, NËPËRMJET SHKARKIMIT NGA TREGU TË PROGRAMIT BLACKBERRY HANDHELD QË LEHTËSON HYRJEN TUAJ NË SHËRBIME SPECIFIKE TË PALËVE TË TRETA DHE/OSE ARTIKUJ TË PALËVE TË TRETA, OSE ME ANË TË LINKEVE NË PROGRAME SPECIFIKE TË PALËVE TË TRETA OSE FAQE TË INTERNETIT TË PALËVE TË TRETA DHE/OSE SHËRBIME TË PALËVE TË TRETA TË VËNA NË DISPOZICION PËR JU NGA IKONAT OSE SHËNUESIT NË PRODUKTIN TUAJ HANDHELD, APO NGA NDONJË MJET TJETËR ÇFARËDO, PËRFSHIRË PA KUFIZIME NË FAQE TË TJERA TË INTERNETIT OSE NDËRMJET INFORMACIONEVE QË ARRIHEN DUKE PËRDORUR PRODUKTIT TUAJ HANDHELD OSE QË JU JANË DHËNË JU NGA RIM OSE NGA NJË FURNIZUES I SHËRBIMIT AIRTIME.
  - (iii) DUKE MOS U KUFIZUAR NGA SA MË SIPËR, PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MENYRE SPECIFIKE NGA LIGJI NË FUQI, TË GJITHE ARTIKUJT E PALËS SË TRETË DHE SHËRBIMET E PALËS SË TRETË JANË DHËNË OSE JANË BËRË TË AKSESUESHME NGA RIM, OSE NË TË KUNDËRT TË PËRDORURA NGA JU SËBASHKU ME TUAJIN BLACKBERRY SOLUTION, MBI BAZËN "AS IS" DHE "AS AVAILABLE", PA ASNJË KUSHT, MIRATIM, PËRFAQËSIM APO GARANCI TË NDONJË LLOJI, DHE RIM NUK KA ASNJË PËRGJEGJËSI KUNDREJT JUSH OSE NDONJË PALE TË TRETË QË

PRETENDON SE NGA OSE NËPËRMJET JUSH, PËR NDONJË ÇËSHTJE NË LIDHJE ME ARTIKUJT E PALEVE TË TRETA, OSE SHËRBIMET E PALEVE TË TRETA, PËRFSHIRË, PA KUFIZIM: (A) SAKTËSINË, TRANSMETIMIN, MUNDËSINË APO DISPONUESHMËRINË E VAZHDUESHME TË KËTYRE ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETA, OSE SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA, APO TË NDONJË PJESË TË PROGRAMIT TË PROJEKTUAR VETËM PËR TË MUNDËSUAR NJË AKSES TË TILLË; (B) ZBATIMIN OSE JO TË ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETA, OSE SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA; OSE (C) NDËRVEPRIMIN E ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETA, OSE SHËRBIMEVE TË PALËVE TË TRETA ME TË GJITHA OSE ME NJË PJESË TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION

(iv) DUKE MOS U KUFIZUAR NGA SA MË SIPËR, PËRVEÇ RASTEVE TË NDALUARA NË MËNYRË SPECIFIKE NGA LIGJI NË FUQI, JU BINI DAKORT NË MËNYRË TË VEÇANTË QË RIM NUK ËSHTË PËRGJEGJËS PËR, NDONJË VIRUS, OSE NDONJË KËRCËNIM, SHPIFJE, PAHIJËSHMËRI, GABIME, OFENDIME OSE SHËRBIME TË PALIGJSHME TË PALËVE TË TRETA, ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETA OSE PËR ÇDO ARTIKULL TË PALËVE TË TRETA OSE SHËRBIM TË PALËVE TË TRETA OSE TRANSMETIMIT TË TYRE, QË CËNOJNË ÇDO TË DREJTË PRONËSIE INTELEKTUALE TË PALËVE TË TRETA. REKURSI TUAJ NË RASTIN E NDONJË PRETENDIMI TË TILLE NË LIDHJE ME NDONJË ARTIKULL TË PALËVE TË TRETA, OSE SHËRBIM TË PALËVE TË TRETA, DO TË JETË VETËM KUNDËR PALËVE TË TRETA PËRKATËSE.

(d) Aplikimet Mission Critical. JUAJA BLACKBERRY SOLUTION DHE ÇDO PJESË E SAJ, NUK ËSHTË E PËRSHTATSHME PËR TU PËRDORUR NË APLIKIMET MISSION CRITICAL OSE NË MJEDISËT ME RREZIK TË CILAT KËRKOJNË KONTROLL SIGURIE, QË PËRFSHIN, PA KUFIZIM, OPERIMIN E PAJISJEVE NUKLEARE, NAVIGACIONIN AJROR OSE SISTEMET E KOMUNIKIMIT, KONTROLLIN E TRAFIKUT AJROR, DHE MBESHTJETJEN E JETËS OSE SISTEMET E ARMËVE. PA U KUFIZUAR NGA SA ME SIPËR JU PARAQISNI DHE GARANTONI SE GJATË PËRDORIMIT TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION DO TË MBANI SISTEME REKUPERIMI TË DHËNASH TË MJAFTUESHËM DHE SISTEME MBËSHTETËSE, DHE NË RASTIN E: (i) NDËRPRERJES SË PËRDORIMIT OSE SHËRBIMIT; OSE (ii) VËSHTIRËSIVE OSE GABIMEVE NË TRANSMETIMIN E TË DHËNAVE; JU BINI DAKORT QË MENJËHERE TË ZVOGËLONI TË GJITHA HUMBJET OSE DËMTIMET DHE TË RAPORTONI KËTO ÇËSHTJE TE RIM.

## 20. Kufizimi i Përgjegjësisë.

DISA SHTETE NUK LEJOJNË KUFIZIMIN OSE PËRJASHTIMIN KONSEKUENT, INDIREKT APO DËMEVE TË TJERA NË KONTRATAT ME KONSUMATORËT DHE PËR AQ SA JU JENI NJË KONSUMATOR KUFIZIMET OSE PËRJASHTIMET NË KËTË PIKË MUND TË MOS ZBATOHEN PËR JU.

(a) DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT NË FUQI, DHE SUBJEKT I KOMPENSIMEVE TË VEÇANTA TË PARASHIKUARA NË KËTË

MARRËVESHJE, NË ASNJË RAST RIM NUK DO TË JETË PËRGJEGJES PËR ÇFARËDO TIP DËMTIMI TË MËPOSHTËM: KONSEKUEANTE, SHEMBULLORE, AKSIDENTALE, INDIREKTE, SPECIALE, NDËSHKIMORE, OSE DËMET E PROVOKUARA, DËMET E SHKAKTUARA NGA HUMBJA E FITIMIT TË BIZNESIT OSE TË ARDHURAT, DËSHTIMI PËR TË REALIZUAR ÇDO TË ARDHUR TË PRITUR, NDËRPRERJE TË BIZNESIT, HUMBJE TË INFORMACIONIT TË BIZNESIT, HUMBJE TË MUNDËSISË SË BIZNESIT, OSE KORRUPSIONI OSE HUMBJE TË TË DHËNAVE, DËSHTIM PËR TË TRANSMETUAR OSE PËR TË MARRË NDONJË TË DHËNË, PROBLEME TË LIDHURA ME ÇDO APLIKIM TË PËRDORUR NË LIDHJE ME TUAJIN BLACKBERRY SOLUTION, HUMBJE SHPENZIMESH, JOPRODUKTIVE, HUMBJE TË PËRDORIMIT TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION OSE NDONJË PJESË TË SAJ OSE TË SHËRBIME TË PALËVE TË TRETA OSE ARTIKUJVE TË PALËVE TË TRETA, KOSTOJA E ZËVENDËSIMIT TË MALLRAVE, KOSTOT E MBULIMIT, MJETEVE OSE SHËRBIMEVE, KOSTON E KAPITALIT, OSE HUMBJET E TJERA TË NGJASHME NË PARA QË DALIN NGA APO NË LIDHJE ME KËTË MARRËVESHJE APO JUAJA BLACKBERRY SOLUTION DUKE PËRFSHIRË PËRDORIMIN OSE PAAFTËSINË PËR TË PËRDORUR, PËRFORMUAR OSE JO TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION, NËSE KËTO DËME ISHIN OSE JO TË PARASHIKUARA APO TË PAPANASHIKUARA, EDHE NËSE RIM-IT I ËSHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E KËTYRE DËMEVE.

- (b) Deri në masën maksimale të lejuar sipas ligjit në fuqi, në asnjë rast përgjegjësia totale e RIM do të tejkaloj sasinë e: (i) shumës së paguar nga Ju për Produktet e RIM, dhe/ose për atë pjesë të Programeve (sipas rastit mund të jetë) që ngre pretendimin; dhe (ii) pesë (5) dollar Amerikan.
- (c) Deri në masën maksimale të lejuar sipas ligjit në fuqi, pavarësisht nga çdo gjë tjetër në këtë Marrëveshje, deri në masën që RIM është përgjegjës ndaj Jush, RIM do të jetë përgjegjës vetëm për dëmet e shkaktuara gjatë periudhës të këtij dështimi, vonëse apo jo performance të Tuajes BlackBerry Solution.
- (d) Asgjë në këtë Pikë nuk kufizon përgjegjësitë e RIM ndaj Jush në rast: (i) vdekje ose dëmtimi personal në masën që rezulton direkt nga pakujdesia e RIM; ose (ii) çdo akt i qëllimshëm mashtrues ose mosveprim i qëllimshëm mashtrues i RIM-it.
- (e) DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT NË FUQI, ÇDO PALË DO TË KETË PËRGJEGJËSI KUNDREJT TJETRËS VETËM SIÇ ËSHTË PARASHIKUAR SHPREHIMISHT NË KËTË MARRËVESHJE DHE NUK DO TË KETË ASNJË DETYRIM TJETËR, DETYRË, OSE PËRGJEGJËSI TË ÇDOLLOJI QOFTË NË KONTRATË, SHKELJE CIVILE OSE TJETËR.
- (f) DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR SIPAS LIGJIT NË FUQI, KUFIZIMET, PËRJASHTIMET, NË KËTË MARRËVESHJE DO TË: (i) APLIKOHEN PAVARËSISHT NGA NATYRA E SHKAKUT TË VEPRIMIT, KËRKESËS OSE VEPRIMIT, NGA JU DUKE PËRFSHIRE, POR PA KUFIZIM NË, NEGLIZHENCË, GABIM, PËRGJEGJËSI TË RREPTË, SHKELJE TË KONTRATËS, OSE NDONJË TËORI TJETËR LIGJORE; (ii) JENË NË FUQI MBI ÇDO SHKELJE THELBËSORE OSE DËSHTIMIN E QËLLIMIT ESËNCIAL TË KËSAJ MARRËVESHJEJE OSE TË NDONJË KOMPENSIMI TË

PËRFSHIRË KETU, (iii) MOS ZBATOHEN DETYRIMET E DËMSHPËRBLIMIT TË PËRCAKTUARA KETU OSE SHPËRDORIMET OSE SHKELJET NGA CILADO PALË PËR PRONËSINË INTELEKTUALE TË PALËS TJETËR, OSE NJË SHKELJE E PIKAVE TË KËSAJ MARRËVESHJEJE TË QUAJTURA: "MBËSHTETJE KRIPTOGRAFIKE E DESKTOP-IT" (PIKA 6), "PËRDORIMI I TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION" (PIKA 3), "LIÇENSA E PROGRAMIT DHE DOKUMENTACIONIT" (PIKA 2), "PRONËSIA INTELEKTUALE" (PIKA 7), "KUFIZIMET E IMPORTIMIT, EKSPORTIMIT DHE PËRDORIMIT DHE LIÇENSAT E QEVERISË TË SH.B.A" (PIKA 9), DHE "KONFIDENCIALITETI DHE ASNJË NDRYSHIM INXHINIERIK" (PIKA11); DHE (iv) APLIKOHEN NË PËRGJITHËSI, TEK RIM APO GRUPIN E KOMPANIVE RIM, TRASHËGIMTARËVE TË TYRE, PËRFITUESIT, DHE SHPËRNDARËSVE TË AUTORIZUAR TË RIM (DUKE PËRFSHIRË FURNIZUESIT E SHËRBIMIT AIRTIME QË VEPRON SI SHPËRNDARËS TË PROGRAMIT TË AUTORIZUAR TË RIM-IT).

- (g) NË ASNJË RAST NDONJË NËPUNËS, DREJTOR, PUNONJËS, AGJENT, SHPËRNDARËS, FURNIZUES, FURNIZUES SHËRBIMI, KONTRAKTUES I PAVARUR, OSE ÇDO FURNIZUES TË SHËRBIMIT (PËRVEC SIÇ PËRCAKTOHET ME SIPËR) I RIM OSE KOMPANITË E GRUPIT RIM NUK KANË NDONJË PËRGJEGJESI QË RRJEDHIN NGA OSE NË LIDHJE ME KETË MARRËVESHJE.
- (h) JU PRANONI DHE BINI DAKORT QË REFUZIMET, PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET E PËRCAKTUARA NË KËTË MARRËVESHJE PËRBËJNË NJË ELEMENT THELBËSOR TË MARRËVESHJES MIDIS PALËVE DHE SË NË MUNGESË TË KETYRE REFUZIMEVE, PËRJASHTIMEVE DHE KUFIZIMEVE: (i) TARIFAT DHE KUSHTET E TJERA NË KËTË MARRËVESHJE DO TË JENË THELBËSISHT TË NDRYSHME, DHE ( ii) AFTËSIA E RIM-IT PËR TË OFRUAR DHE AFTËSIA JUAJ PËR TË PËRFITUAR LIÇENSËN E PROGRAMIT SIPAS KËSAJ MARRËVESHJE DHE/OSE AFTËSIA E RIM PËR TË BËRË ARTIKUJT E PALËS SË TRETË DHE SHËRBIMET E PALËS SË TRETË TË ARRITSHME NËPËRMJET TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION DO TË KËTË NDIKIM.

ASGJË NË KËTË MARRËVESHJE NUK KA SI QËLLIM TË ZËVËNDËSOJË NDONJË MARRËVESHJE TË SHKRUAR OSE GARANCI TË SIGURUAR NGA RIM SI PJESË TË TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION PËRVEC PROGRAMEVE DHE SHËRBIMEVE.

## 21. Miratimi i Mbledhjes së Informacionit

- (a) Instalimi dhe/ose Përdorimi Juaj i Tuajit BlackBerry Solution (apo ndonjë pjesë të tyre) dhe/ose i Shërbimit ose i lidhur me Shërbimin Airtime mund të rezultojë në mbledhjen, përdorimin dhe/ose zbulimin e informatave personale rreth Jush dhe/ose Përdoruesve Tuaj të Autorizuar (i cili mund ose jo, në varësi të ligjit në fuqi, të përfshijë, pa kufizim, një emër, adresë e-maili, numër telefoni, informacion për Produktin Handheld, informacion mbi vendin e Produktit Handheld (siç përshkruhet më poshtë), informacion për Furnizuesin e Shërbimit Airtime, dhe informacion në lidhje me përdorimin e funksionit të Zgjidhjes Suaj BlackBerry ose program dhe hardware të përdorur në lidhje me Zgjidhjen Tuaj BlackBerry), nga RIM, Furnizuesi

Juaj i Shërbimit Airtime , palë të treta me produkte apo shërbime të përdorura me Zgjidhjen Tuaj BlackBerry dhe/ose kompanitë e bashkuara të enteve të përcaktuara në këtë fjali. Ju jepni pëlqimin Tuaj për grumbullimin, përdorimin, përpunimin, transmetimin, dhe/ose zbulimin e informatave të tilla nga Grupi i Kompanive RIM të vendosur në një vend ose territor brenda ose jashtë juridiksionit Tuaj, dhe Ju garantoni që Ju keni marrë të gjitha pëlqimet e nevojshme nga Përdoruesit Tuaj të Autorizuar sipas ligjit të zbatueshëm që t'ia shpalosni informacionet e tyre personale Kompanive të Grupit RIM dhe për Kompanitë e Grupit RIM që të grumbulloje, përdor, procesoje, transmetojë, dhe/ose që të zbuloje keto informacione personale, të cilat mund të përfshijnë gjithashtu përdorimin, përpunimin, transmetimin, dhe/ose zbulimin e këtyre informatave Furnizuesit të Shërbimit Airtime Tuaj dhe/ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar, palëve të treta me produktë ose shërbime të përdorura me Tuajin BlackBerry Solution, dhe/ose brenda Kompanive të Grupit RIM, për: (i) përdorim të brendshëm të Kompanive të Grupit RIM, duke përfshirë, pa kufizim: (A) mirëkuptim dhe plotësim të nevojave dhe preferencave Tuaja; (B) zhvillimin e shërbimeve të reja dhe rritjen e shërbimeve ekzistuese dhe ofertat e produkteve; dhe (C) menaxhimin dhe zhvillimin e biznesit dhe të operimeve të RIM-it, duke përfshirë sigurimin e funksionimit teknik të produkteve dhe shërbimeve; (ii) çdo qëllim lidhur me faturimin, aktivizimin, dispozitën, mirëmbajtjen, çaktivizimin dhe/ose përdorimin Tuaj dhe/apo të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar të Tuajit BlackBerry Solution dhe/ose produkte dhe/ose shërbime që kanë të bëjnë me to (duke përfshirë Shërbimin), duke përfshirë përmbushjen ose zbatimin afateve dhe kushteve të RIM-it; (iii) duke vënë në dispozicionin Tuaj dhe/ose të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar azhionimet apo përmirësimet e Programeve, njoftimin për azhionimet apo përmirësimet, Programet e Palës së Tretë, Përmbajtjen e Palës së Tretë ose Shërbimet e Palës së Tretë dhe/ose me produktet dhe/ose shërbimet që kanë të bëjnë me to (duke përfshirë Shërbimin); (iv) çdo qëllim të lejuar ose të kërkuar nga cildo ligj në fuqi; dhe/ose (v) çdonjë nga qëllimet e tjera, të cilat janë të përcaktuara në politiken e tanishme të privacisë të RIM, e cila mund të shihet në [http://uk.blackberry.com/legal/privacy\\_policy.jsp](http://uk.blackberry.com/legal/privacy_policy.jsp), ose për të cilin ju përndryshe jepni pëlqimin.

- (b) Përveç informatave të tjera personale të përshkruara në këtë Marrëveshje, kur Ju përdorni Produktin Tuaj Handheld apo mundësoni shërbimet e të dhënave ose të funksionalitetit të bazuar në vend, informacioni i vendit të Produktit Handheld (duke përfshirë, pa kufizim, informacionin GPS, ID e mbajtësit, ID e kullës dhe forcën e sinjalit të Wi-Fi të dukshme ose qëlizen e kullave) mund ti komunikohet Kompanive të Grupit RIM-it. Kompanitë e Grupit RIM mund të përdorin keto informacione për t'ju siguruar Juve me shërbimet e atij vendi, duke përfshirë, pa kufizim, shërbime që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit të vendit të produktit Tuaj Handheld me persona të tjerë, duke përfshirë, pa kufizim, Shërbime të Palëve të Treta që përdoren me Tuajin BlackBerry Solution. Ju duhet ta konsideroni mire para së të bini dakord që t'ia zbuloni informacionet Tuaja personale personave të tjerë. Në gjithashtu mund t'i përdorim këto informacione për të krijuar të dhëna në të cilat Informacioni Juaj personal është grumbulluar ose është bërë anonim, dhe mund ta përdorin atë për të bërë publicitet në territor të ndjeshëm.
- (c) Mbledhja, përdorimi, përpunimi, transmetimi, dhe/ose dhënia e informacionit Tuaj personal ose i Personave Tuaj të Autorizuar për qëllimet e shënuara me sipër janë në përputhje me politiken e privacisë të RIM. RIM ka të drejtën të modifikojë politiken e tij të privacisë herë pas here sipas zgjedhjes së tij të vetme dhe Ju duhet ta shikoni rregullisht politiken e privacisë të RIM për ndryshime. Nëse

informacioni Juaj personal i jepet Furnizuesit Tuaj të Shërbimit Airtime, ose palëve të treta me produkte ose shërbime të përdorura me Tuajin BlackBerry Solution, Politika e Privacisë e Furnizuesit të Shërbimit Airtime ose Palëve të treta, ose afatet dhe kushtet në lidhje me grumbullimin, përdorimin, përpunimin, transmetimin, dhe/ose zbulimin e informacionit personal të negociuar midis RIM-it dhe Furnizuesit Tuaj të Shërbimit Airtime dhe/ose të Furnizuesit të Shërbimit Airtime të Përdoruesve Tuaj të Autorizuar apo të palëve të treta të aplikueshme me produktet ose shërbimet e përdorura me Tuajin BlackBerry Solution, nëse ka, do të zbatohet. Ju bini dakort që të informoni të gjithë individët, informacionin personal të së cilëve Ju ja siguron RIM-it që ata mund të kenë të drejta që të hyjnë dhe të korrigjojnë informacionin e tyre personal në bazë të ligjit të zbatueshëm.

22. Feedback. Ju mund ti jepni RIM-it feedback në lidhje me Tuajin BlackBerry Solution. Përveç rastit kur RIM ka rënë dakord ndryshe me shkrim, Ju në këtë mënyrë bini dakort që RIM të zotëroj të gjitha feedback-et, komentet, sugjerimet, idetë, konceptet dhe ndryshimet që Ju i ofroni RIM-it lidhur me Tuajin BlackBerry Solution dhe të gjithëcka lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale (kolektivisht "Feedback") dhe Ju këtu i caktoni RIM-it të gjitha të drejtat Tuaja, titullin dhe interesin. Ju nuk do ti jepni ndonjë Feedback RIM-it me vetëdije që është subjekt i të drejtës së pronësisë intelektuale të palës së tretë. Ju pranoni të bashkëpunoni plotësisht me RIM-in në lidhje me nënshkrimin e dokumenteve të mëtejshme dhe duke bërë akte të tjera të tilla që kërkohen me arsye nga RIM për të konfirmuar që RIM zotëron Feedback dhe për të mundësuar RIM-in që të regjistrohet dhe/ose të mbrojë në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe/ose informacione konfidenciale.

23. Transferimi dhe Delegimi. RIM mund të transferoj këtë Marrëveshje pa Ju njoftuar. Ju nuk do ta transferoni këtë Marrëveshje në tëresi ose në pjesë pa miratimin me shkrim të RIM (ky miratim mund të ndalohet ose të kushtëzohet sipas gjykimit të RIM) dhe çdo transferim pa miratimin me shkrim të RIM do të jetë i pavlefshëm dhe do të anulohet dhe nuk do të ketë efekt. RIM mund të kryejë të gjitha detyrimet që përmbushen nën këtë Marrëveshje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose mund të ketë disa ose të gjitha detyrimet e përmbushura nga kontraktuesit ose nënkontraktuesit e tij, dhe/ose në rastin e Shërbimeve Airtime, nga Furnizuesi i Shërbimit Airtime ose shoqëritë e kontrolluara dhe filialet e tij.

24. Njoftime. Përveç rastëve të parashikuara ndryshe në Marrëveshje, të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera këtu do të konsiderohen të dhëna sipas mënyrës së duhur nëse ato janë bërë me shkrim dhe shpërndarë me person, me korrier ose depozituar në postë, me tarifë postare të parapaguar, me rekomandim ose ekuivalentin e tij, mandate kthimi i kërkuar, dhe adresuar Juve në adresën që i keni dhënë RIM-it, dhe i adresuar të Research in Motion UK Limited, Centrum House, 36 Station Road, Egham, Surrey, UK, TW20 9LF, me një kopje (e cila nuk përbën njoftim) drejtuar Menaxherit të produkteve RIM në të njëjtën adresë. Përveç sa me sipër, RIM mund, të zgjedh që, t'ju japi ndonjë njoftim lidhur me këtë Marrëveshje elektronikisht. Njoftimi elektronik do të konsiderohet i dhënë në mënyrën e duhur nëse transmetohet në adresën e e-mailit të dhënë RIM-it nga Ju dhe nëse Ju nuk i keni dhënë RIM-it këtë adresë, njoftimi mund të jepen siç duhet kur do të postohet dukshëm në <http://www.blackberry.com/legal/>.

25. Forcë madhore. Pavarësisht çdo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshje, asnjë nga Palët nuk do të konsiderohen në mungesë të kësaj Marrëveshjeje për mospërmbushje të detyrimeve të saja për shkak të arsyeve që kalojnë përtej kontrollit të arsyeshëm. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet si moskryerje e justifikuar e çdo detyrimi nga secila Palë për ti bërë pagesën Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

26. Të përgjithshme

- (a) Përfituesit e Palës së Tretë. Filialet RIM dhe RIM dhe drejtorët filialeve të saj, oficeret dhe punonjësit e tyre nënkuptohen të jenë përfituesit e palës së tretë për qëllimin e Pikave të kësaj Marrëveshjeje të quajtura, "Kufizimi i përgjegjësisë" (Pika 20) dhe "Refuzimet" (Pika 19). Përveç siç shprehet ndryshe në mënyrë specifike në këtë Pikë, dispozitat këtu janë për të mirën e Palëve dhe jo për ndonjë person apo ent tjetër.
- (b) Heqja dorë nga mospërmbushja e detyrimeve. Asnjë Palë nuk do të konsiderohet të ketë hequr dorë ose humbur ndonjë të drejtë nën këtë Marrëveshje, qoftë në bazë të mospërmbushjes së detyrimeve, vonesës apo të ndonjë të drejtë ose doktrinë tjetër ligjore, përveç në së heqja e dorës është bërë me shkrim dhe nënshkruar nga një nënshkruar i autorizuar i Palës përkundrejt së cilës heqja dorë kërkohet të zbatohet. Heqja dorë nga ndonjë dispozitë, ose shkelja e ndonjë dispozitë, të kësaj Marrëveshjeje në një instance nuk do të thotë heqje dore për sa i përket ndonjë instance tjetër.
- (c) Lënia në fuqi. Afatet, kushtet dhe garancitë të përfshira në këtë Marrëveshje që sipas kuptimit apo kontekstit kanë për qëllim ti mbijetojnë ekzekutimit të saj do ti mbijetojnë dhe përmbushjes së ekzekutimit, anulimit dhe përfundimit të Marrëveshjes.
- (d) Ligji dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve. Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Anglisë dhe Uellsit duke përjashtuar cilin do organizem të së drejtës që rregullon konfliktet ligjore. Palët bien dakort që Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratën për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave përjashtohet këtu në tërësi nga aplikimi të kësaj Marrëveshjeje. Çdo mosmarrëveshje ose diskutim që del jashtë ose është në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelje të tyre, të cilat Palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin pas negociatave në mirëbesim, duhet të dorëzohen fillimisht nivelit më të lartë të menaxhimit të Palëve. Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të nivelit më të lartë të menaxhimit, të cilat nëse jeni një individ, jeni Ju, do të takohen brenda tridhjetë (30) ditësh nga mosmarrëveshja e drejtuar atyre dhe në qoftë së Palët nuk janë në gjendje për të zgjidhur këto mosmarrëveshje ose diskutime brenda tridhjetë (30) ditëve të takimit, përveç për atë që ndalohej specifikisht nga ligji në fuqi në juridiksionin Tuaj, mosmarrëveshje të tilla ose diskutime do të zgjidhen nga arbitrazhi përfundimtar dhe detyruar që do të zhvillohet në Londër, Angli në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("Rregullat e ICC") dhe do të dëgjohet nga një arbitër i emëruar në përputhje me Rregullat e thëna të ICC dhe do të bihet reciprokisht dakord nga Palët brenda tridhjetë (30) ditëve nga emërimi i arbitrit, në mungesë të së cilit arbitri do të emërohet nga Kryetari i Shoqërisë Britanike Kompjuterike (ose nga një person i emëruar nga Presidenti për të vepruar në emrin e tij ose të saj) mbi zbatimin e secilës Palë për kohën që është në fuqi, rregulla të cilat konsiderohen të jenë inkompatuar me referencë në këtë klauzolë. Nëse dispozitat e mësipërme janë të ndaluara me ligj në juridiksionin Tuaj, arbitrazhi do të jetë: (i) i mbajtur në juridiksionin Tuaj; (ii) i vendosur me arbitrazh në përputhje me rregullat e arbitrazhit dhe Procedurat e Qendrës MEDART ("Rregullat e MEDART"); dhe (iii) i dëgjuar nga një arbitër i emëruar në përputhje me Rregullat e MEDART të bihet reciprokisht dakord nga Palët brenda tridhjetë (30) ditëve nga emërimi i arbitrit, në mungesë të së cilit, një palë e tretë asnjë do të emërojë arbitrin. Secila Palë do të paguaj gjysmën e shpenzimeve lidhur me procedurat e arbitrazhit. Asnjë mosmarrëveshje midis Palëve, ose që përfshin ndonjë person përveç Jush, mund të bashkohet apo të kombinohet së bashku, pa pëlqimin paraprak me shkrim të RIM. Gjykimi mbi çmimin e dhënë nga ana e arbitrit mund të hidhet në çdo Gjykatë që ka

juridiksion. Pavarësisht nga e mësipërmja, RIM ka të drejtë që të paraqesë procedurat ligjore ose të barabarta, duke përfshirë edhe procedura që kërkojnë vendim lehtësues, në një gjykatë për pretendime apo mosmarrveshje lidhur me: (i) shumat që Ju i detyroheni RIM në lidhje me blerjen Tuaj të Tuajit BlackBerry Solution ose ndonjë pjesë të saj, nëse zbatohet, dhe (ii) për shkeljen Tuaj apo kërcënimin për shkelje të Pikave të Marrëveshjes të quajtura, "Mbështetje Kriptografike e Desktop-it" (Pika 6), "Përdorimi i Tuajit BlackBerry Solution" (Pika 3), "Liçensa e Programit dhe Dokumentacionit" (Pika 2), "Pronësia Intelektuale" (Pika 7), "Kufizimet e Eksportimit, Importimit dhe Përdorimit dhe Liçensat e Qeverisë të SH.B.A". (Pika 9), "Siguria"(Pika 10), "Konfidencialiteti dhe Asnjë Ndryshim Inxhinierik" (Pika 11) dhe "Pasoja e Zgjidhjes" (Pika 14). Ju heqni dorë në mënyrë të përvokueshme nga ndonjë vërejtje për shkak të vendit të punës, forumit jo-të përshtatshëm apo për ndonjë arsye të ngjashme dhe jepni pelqimin e përvokueshem për shërbim të procesit me postë ose në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar nga ligji në fuqi dhe jepni pelqimin e përvokueshem, i nënshtroheni dhe pranoni juridiksionin e gjykatave të ndodhura në Angli për çdo pretendim të tillë që del nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje. Palët pajtohen në mënyrë specifike që, në rast se ka ndonjë mosmarrëveshje me këtë Marrëveshje dhe keto mosmarrëveshje do të zgjidhen në një gjykatë, mosmarrëveshje të tilla nuk do të zgjidhen nga juria. Palët heqin dorë ketu nga të gjitha të drejtat për gjykim të jurisë për çdo çështje në lidhje me ose që del nga kjo Marrëveshje.

- (e) Pavlefshmëritë. Për aq kohë sa çdo Pike, klauzolë, dispozitë apo fjali apo pjesë ("Pjesë") e kësaj Marrëveshjeje vendoset që është e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një autoritet kompetent në ndonjë juridiksion, atëherë ky vendim i kësaj Pjese nuk do të ndikojë në: (i) ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e Pjesëve të mbetura të kësaj Marrëveshjeje; ose (ii) ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e kësaj Pjese në ndonjë juridiksion tjetër, dhe kjo Pjesë do të jetë e kufizuar nëse është e mundur dhe vetëm më pas e prerë, nëse është e nevojshme, për aq sa kërkohet që ta bëjë Marrëveshjen të vlefshme dhe të zbatueshme.
- (f) Gjuha. Nëse kjo Marrëveshje është përkthyer në një gjuhë tjetër veç Anglishtës, versioni Anglisht do të ketë përparësi në rastet kur do të ketë ndonjë konflikt ose mospërputhje në përmbajtje ndërmjet versionit Anglisht dhe çdo lloj përkthimi tjetër. Përveç, dhe vetëm për aq sa, ndalohet me ligj nga juridiksioni Juaj, çdo ose të gjitha mosmarrëveshjet, konfliktet, ndërmjetesët, arbitrazhet apo çështje gjyqësore në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhen në gjuhën Angleze duke përfshirë, pa u kufizuar, çdo lloj korrespondence, zbulimi, paraqitje, depozitim, lutje verbale, diskutime, diskutime verbale dhe urdhëra ose gjykime.
- (g) Mospërputhja. Në qoftë se ka ndonjë mospërputhje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe çfarëdo liçensë programi ose marrëveshjeje e Përdoruesit Fundor (të ndryshme nga kjo Marrëveshje) të dhënë në materialet paketuesë ose shoqëruesë të çfarëdo pjesë të Tuajit BlackBerry Solution, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen për aq sa është mospërputhja. Në qoftë se ka ndonjë mospërputhje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe çfarëdo liçensë programi ose marrëveshjeje e Përdoruesit Fundor në lidhje me çfarëdo azhurnimi ose përmiresimi të Programit, dispozitat e një marrëveshjeje tjetër të tillë ose marrëveshjeje me përdoruesin Fundor do të zbatohen për aq sa është mospërputhja. Në rastin e çfarëdo mospërputhjeje ndërmjet çdo dokumentacioni të dhënë në paketim të çdo pjesë të Tuajit BlackBerry Solution dhe Dokumentacionit për Produktin e përshtatshëm të RIM ose artikull të Programit, dispozitat e Dokumentacionit do të zbatohen për aq sa është mospërputhja

- (h) Marrëveshja në tërësi. Kjo marrëveshje (e cila për qëllim të çdo Shtesë ketu, do të përfshijë në lidhje me objektin e Shtesës, kushtet e kësaj Shtesë), përbën marrëveshjen në tërësi të Palëve në lidhje me objektin këtu dhe nuk ka dispozita, mirekuptime, komunikime, përfaqësime, garanci, ndërmarrje, marrëveshje kolaterale ose marrëveshje midis Palëve lidhur me Programin përveç asaj të përmendur në këtë Marrëveshje. Pavaresisht sa më sipër marrëveshje të tjera midis Palëve mund të rregullojnë përdorimin e pjesëve të tjera të Tuajit BlackBerry Solution. Kjo Marrëveshje shfuqizon çfarëdo dispozitë të mëparshme ose bashkëkohore, mirekuptime, komunikime, përfaqësime, garanci, ndërmarrje, marrëveshje kolaterale ose marrëveshje midis Palëve, qofshin ato verbale ose me shkrim, në lidhje me këtë objekt dhe Ju pranoni që nuk mbështeteni në asnjë nga të sipërpërmendurat duke pranuar të lidhni këtë Marrëveshje. Kjo Marrëveshje mund të amendohet në çdo kohë me rënien dakort reciprokisht nga Palët. Përveç rastëve kur RIM është shprehimisht i ndaluar me ligj, RIM rezervon të drejtën ta ndryshojë këtë Marrëveshje mbi një bazë të ardhshme, qoftë për të pasqyruar ndryshimet në ose të kërkuara nga ligji (duke përfshirë, pa kufizim ndryshime për të siguruar zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje) ose për të ndryshuar praktikatat e biznesit, duke Ju njoftuar paraprakisht mbi ndryshimet qoftë në mënyrë elektronike (Siç parashikohet nga dispozita Njoftimit me lart) ose duke vendosur lajmërimin e ndryshimit në <http://www.blackberry.com/legal> dhe Ju duhet ta shikoni regullisht faqen e internetit për ndryshime. Nëse Ju vazhdoni të përdorni Programin dhe/ose Shërbimin për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dhënies së njoftimit mbi ndryshimin, do të konsiderohet që Ju e keni pranuar këtë ndryshim. Nëse keni ndonjë shqetësim në lidhje me ndryshim(et) ju lutem kontaktoni [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com) brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas dhënies së njoftimit për ndryshim(et) për të kërkuar opsionet Tuaja.
- (i) Përputhja me Ligjet. Ju, me shpenzimet Tuaja, do të merrni dhe mirëmbani të gjitha licencat, regjistrimet dhe miratimet e kërkuara nga autoritetet shtetërore ose ligji përkatës në juridiksionin Tuaj për zbatimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshje ose ndonjë marrëveshje licensë të ngjashme. Në veçanti si dhe për të shmangur çdo dyshim, Ju do të zbatoni ligjet dhe rregullat përkatëse dhe do të siguron, çdo licencë, regjistrim dhe miratim të nevojshëm nga autoritetet shtetërore kompetente për importimin dhe përdorimin e çdo Programi që përmban shënime komerciale apo funksion tjetër sigurie të kërkuar nga ligji përkatës. Ju do të siguron RIM-it vërtëtimet dhe dokumentat zyrtare që mund të kërkojë periodikisht për të verifikuar përputhshmërinë Tuaj me këtë detyrim.

27. Bashkimi i Marrëveshjeve. Për të garantuar: (a) kushtet konsistente të zbatueshme në Programin BlackBerry për kompjuterin personal, Programin BlackBerry të Serverit dhe Programin e BlackBerry HandHeld, kur secili përdoret si pjesë e Tuajit BlackBerry Solution; dhe b) qartësi për sa i përket se cilat kushte të licensës aplikohen tek Programi BlackBerry Handheld, kur përdoret si pjesë e Tuajit BlackBerry Solution, pavarësisht mënyrës se si e keni përfutur atë Program BlackBerry Handheld, **DUKE PRANUAR KUSHTET E KESAJ MARRËVESHJE NË MËNYRËN E PËRSHKRUAR ME SIPËR, JU GJITHASHTU BINI DAKORT QË KJO MARRËVESHJE ZËVËNDËSON DHE SHFUQIZON MARRËVESHJET E MËPARSHME EKZISTUESE PËR LIÇENSËN E PROGRAMIT BLACKBERRY TË PËRDORUESIT FUNDOR DHE MARRËVESHJEN E LIÇENSËN SË PROGRAMIT TË SERVERIT BLACKBERRY ENTERPRISE DHE ÇDO MARRËVESHJE TJETËR TË MËPARSHME EKZISTUESE PËR LIÇENSËN E PROGRAMIT BLACKBERRY, PËR AQ SA KETO MARRËVESHJE JANË TË**

**APLIKUESHME, QË NGA DATA E PRANIMIT TË KESAJ MARRËVESHJEJE, PËR ÇDO PROGRAM QË BËN PJESË E TUAJIT BLACKBERRY SOLUTION.**

Të gjitha referencat lidhur me Liçensën e Programit BlackBerry të Përdoruesit Fundor ose Marrëveshjen e Liçensës së Programit të Serverit të BlackBerry Enterprise në marrëveshje ose dokumentacione të tjera që Ju keni me RIM për Tuajin BlackBerry Solution, do të konsiderohen si referenca të kësaj Marrëveshje për Liçensën e Tuajit BlackBerry Solution (përveç për atë që, këto referenca nuk do të kishin kuptim në përmbajtje, p.sh. ku, si në këtë dispozitë, nëse ka një dallim midis marrëveshjeve të mëparshme ekzistuese dhe Marrëveshjeve për Liçensën e Programit BlackBerry, referencat në marrëveshjet e mëparshme ekzistuese nuk do të konsiderohen si referenca të Marrëveshjeve për Liçensën për Programin BlackBerry).

Çdo amendim ose shtesë në Marrëveshjet e mëparshme ekzistuese për Liçensën e Programit BlackBerry të Përdoruesit Fundor ose Marrëveshjet e Liçensës së Programit BlackBerry Enterprise ose Marrëveshjet e Liçensës së Programit BlackBerry në bazë të së cilave Ju u pajisët me programin nga RIM, do të konsiderohen si amendime ose shtesa për këtë Marrëveshje Liçensë të Tuajit BlackBerry Solution.

**NË SE KENI NDONJË PYETJE OSE SHQETËSIM NË LIDHJE ME KUSHTET E KESAJ MARRËVESHJEJE, JU LUTEM KONTAKTONI RIM NË [legalinfo@rim.com](mailto:legalinfo@rim.com).**